



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Nr.Br.No. 01 / 445

DAT.DT. 18.03.2022
PRISHTINË - A

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

UDHËZUES THEMELOR I REFERIMIT PËR TRUPAT PARA-HETUESE DHE HETUESE NË KRYERJEN E HETIMEVE NE ÇESHTJET DISIPLINORE GJYQËSORE

Tabela e Përmbajtjes

PJESA 1: QËLLIMI DHE STRUKTURA E UDHËZUESIT REFERUES.....	3
PJESA 2: PASQYRË E PROCESIT DISIPLINOR.....	5
PJESA 3: STANDARDET DHE PRAKTIKA NDËRKOMBËTARE - SISTEMET DISIPLINORE...7	
PJESA 4: PROCEDURA PARA-HETIMORE.....	8
PJESA 5: PROCEDURA HETIMORE.....	12
PJESA 6: TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË HETIMIT NË PROCES TË RREGULLT.....	27
PJESA 7: MARRËVESHJA VULLNETARE NË RASTET DISIPLINORE.....	31
SHTOJCA 1 - FORMULARËT STANDARD.....	34
SHTOJCA 2 - GRAFIKËT E SISTEMIT DISIPLINOR.....	85
SHTOJCA 3 - STANDARDET DHE PRAKTIKA NDËRKOMBËTARE - SISTEMET DISIPLINORE.....	86

PJESA 1: QËLLIMI DHE STRUKTURA E UDHËZUESIT REFERUES

Ky Udhëzues Themelor Referues (këtu e tutje, "Udhëzuesi") ka për qëllim të jetë mjet praktik për përdorim nga Autoritetet Kompetente dhe Panelet Hetimore, të themeluara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm, "Këshilli"), për kryerjen e hetimeve në çështjet disiplinore gjyqësore. Ky Udhëzues, megjithatë, është hartuar kryesisht për të ndihmuar Panelet Hetimore të kryejnë aktivitetet rutinore hetimore, ashtu që hetimet disiplinore të zhvillohen në mënyrë të drejtë dhe në kohën e duhur, si dhe ashtu që e drejta e gjyqtarit për proces të rregullt të respektohet gjatë fazës hetimore. Udhëzuesi mund të ofrojë udhëzime të dobishme për Autoritetet Kompetente, në kryerjen e veprimeve të tyre në procedurë para-hetimore. Ligji Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (këtu e tutje, "Ligji") dhe Rregullorja e Këshillit Nr. 05/2019 mbi Procedurën Disiplinore për Gjyqtarët (këtu e tutje, "Rregullorja") përbëjnë kornizën ligjore për sistemin disiplinor gjyqësor të Kosovës. Ligji i kushton një nen procedurës hetimore dhe një nen zgjidhjes vullnetare të shkeljeve të pretenduara disiplinore. Këto dy(2) nene i përcaktojnë përgjegjësi të konsiderueshme Paneleve Hetimore në kryerjen e hetimeve. Rregullorja e Këshillit i kushton vetëm një nen veprimeve procedurale të Paneleve hetimore. Rregullorja kryesisht rithekson dispozitat e Ligjit, megjithëse përmban informata të rëndësishme në lidhje me detyrën e Panelit Hetimor në njoftimin e gjyqtarit (në tekstin e mëtejshëm: "subjekti i hetimit") për të drejtat e tij/saj si subjekt i procedurës disiplinore. Mungesa e udhëzimeve procedurale në Ligj dhe Rregullore krijon boshllëqe në procedurën dhe praktikën e hetimit, të cilat, nëse nuk adresohen mirëfilli, mund të kontribuojnë në vonesa në hetime, jokonsistencë në procedurë dhe trajtim të padrejtë të subjektit të hetimit.

Duhet të theksohet se ndërsa ky Udhëzues kryesisht thekson rolin dhe funksionin e Paneleve Hetimore, nuk synon të adresojë të gjitha çështjet procedurale që përbëjnë një rast disiplinor, qoftë në procedurë para-hetimore apo hetimore. Për shembull, neni 12 (11) i Ligjit parasheh që Kodi i Procedurës Penale (KPP) zbatohet *mutatis mutandis* në grumbullimin e provave dhe të drejtat e personave nën hetim. Ndërsa, ky Udhëzues përfshin referenca ndaj dispozitave kyçe të KPP-së, të rëndësishme për procesin disiplinor, veçanërisht në lidhje me të drejtat e subjektit të hetimit, zbatimin përfundimtar i dispozitave të KPP-së në procesin disiplinor është çështje që do të përcaktohet me kalimin e kohës nga Këshilli. Është pikëpamje gati universale që një procedurë disiplinore gjyqësore nuk është çështje penale, përkundrazi, është më e ngjashme me çështje administrative. Kështu, zbatimin e KPP-së në procedurë disiplinore i ka kufizimet e veta. Për më tepër, kur dispozitat e Ligjit dhe Rregullores specifikojnë procedurën dhe praktikën në trajtimin e rasteve disiplinore, ato dispozita duhet të kenë përparësi mbi KPP-në në rast të kolizionit.

Ky Udhëzues ofron shpjegim të hollësishëm, hap pas hapi, të procedurave kryesore të procesit të hetimit, siç është kodifikuar në Ligj dhe Rregullore. Kur ka boshllëqe procedurale në Ligj dhe Rregullore, ky Udhëzues rekomandon praktika të mira për t'u marrë parasysh nga Panelet Hetimore, ashtu që të krijohet një procedurë hetimore më uniforme dhe më e qëndrueshme. Praktikën e mira të propozuara janë vetëm rekomandime, si dhe është e kuptueshme që pranimi dhe zbatimin e praktikave të mira ndikohen nga kultura dhe praktika juridike lokale. Për shembull, Ligji dhe Rregullorja nuk specifikojnë standardin e vlerësimit të provave (barra e provës) që duhet përdorur nga Panelet Hetimore, në vlerësimin e gjendjes faktike dhe konkludimit nëse është kryer shkelja disiplinore. Për të adresuar këtë boshllëk, Udhëzuesi rekomandon standardin e "provave të qarta dhe bindëse", si dhe ofron një përkufizim për ta marrë parasysh, e ndoshta edhe për ta zbatuar, nga Paneli. Zbatimin e një standardi të provës nuk mund të merret nëse nuk është në përputhje me traditën dhe praktikën juridike të Kosovës, e si pasojë, vendosja e këtij standardi mund të hasë në rezistencë. Sidoqoftë, është marrë

vendimi që të ofrohen informata mbi standardin e provës, sepse është mjet i dobishëm për të kryer një analizë të arsyetuar të fakteve dhe për të bërë konstatime faktike, veçanërisht kur kontestohet gjendja faktike, ose besueshmëria e dëshmitarit vihet në pyetje. Është vërejtur që vendimet e Panelit Hetues nuk përmbajnë analiza adekuate të arsyeuara të fakteve që janë baza e konkluzioneve të Panelit. Zbatimi i standardit të provës është mjet i mundshëm pune, ashtu që Panelet Hetimore të analizojnë faktet në mënyrë metodike dhe për të nxjerrë gjetjet dhe përfundimet e arsyeuara.

Përderisa fokusi i këtij Udhëzuesi është kryesisht tek faza hetimore e procesit disiplinor, janë dhënë edhe informata më të gjera mbi procesin disiplinor gjyqësor të Kosovës dhe standardet ndërkombëtare, si referenca. **Pjesa 2** ofron një pasqyrë të shkurtër të kornizës ligjore për procedurën disiplinore gjyqësore të Kosovës. **Pjesa 3** përmban informata mbi praktikën e mira ndërkombëtare, relevante për një sistem disiplinor gjyqësor, e të cilat mund të jenë me interes për anëtarët e Panelit. **Pjesa 4** ofron një analizë, të ndarë në hapa, të fazës para-hetimore. Panelet hetimore nuk kanë kurrfarë roli në fazën para-hetimore. Sidoqoftë, për shkak se faza para-hetimore përbën bazën për fazën e hetimit, informatat më të thukta lidhur me fazën para-hetimore mund të jenë të dobishme. **Pjesa 5** përmban një analizë të detajuar të procedurës së hetimit dhe praktikën e mira të rekomanduara. Veprimtaria themelore e Paneleve Hetimore trajtohet në këtë pjesë. **Pjesa 6** trajton të drejtat e subjektit të hetimit në proces të rregullt gjykimi. Panelet Hetimore duhet ta njoftojnë subjektin e hetimit për të drejtat e tij/saj të parapara me Ligj, Rregullore dhe KPP, si dhe pastaj të marrin masa për të siguruar respektimin e këtyre të drejtave. Është me rëndësi kritike që gjyqtari i paditur të ketë qasje në dosjet dhe provat e Panelit Hetimor, si dhe t'i jepet mundësi efektive për t'iu përgjigjur pretendimeve për shkeljen disiplinore. **Pjesa 7** përqendrohet në zgjidhjen vullnetare të rastit disiplinor, në përputhje me marrëveshjen midis Panelit Hetimor dhe subjektit të hetimit. Ligji i jep Panelit Hetimor kompetencën për të autorizuar zgjidhjen e një rasti disiplinor, kur subjekti i hetimit gjatë procedurës pranon shkeljen disiplinore dhe pajtohet me sanksionin disiplinor. Futja e shkeljes disiplinore në marrëveshjen e zgjidhjes vullnetare kërkon që Panelet Hetimore të kenë njohuri për vendosjen e sanksioneve disiplinore (Pjesa 6 ofron një diskutim të faktorëve për sanksionet disiplinore). Pasi që ka disa panele hetimore, me rotacion të anëtarëve të tyre, ka rrezik që panelet të mos vendosin në mënyrë konsistente sanksionet disiplinore, po nuk pati kritere të qarta sanksionesh.

Për të ndihmuar Panelet Hetimore në kryerjen e detyrave të tyre në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren, **Pjesët 5-7** janë organizuar në nën-pjesë, për referim më të lehtë: (a) referencat ligjore, (b) procedura, (c) Komentet, (d) rekomandimet e praktikave të mira dhe (e) format përkatëse. **Shtojca 1**, përmban 18 formularë standardë për përdorim nga Panelet Hetimore. Formularët janë mjete praktike për të plotësuar informatat e dhëna tek **Pjesët 5-7** të Udhëzuesit.

Asnjë Udhëzues nuk është i plotë, e as nuk duhet të jetë statik. Ky Udhëzues është modest në fushëveprim, si dhe thjesht mjet bazë referues për Panelet Hetimore. Ky duhet të rishikohet dhe azhurnohet në mënyrë periodike. Qëllimi i Udhëzuesit është t'i ofrojë Paneleve Hetimore udhëzime dhe forma praktike, në mënyrë që Panelet Hetimore të mund të punojnë efektivisht, dhe gjatë procedurave disiplinore të përmbushin detyrat e tyre në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren. Përgjegjësitë e Paneleve të Hetimit janë substanciale. Nëse ekzekutohen mirëfilli, Panelet Hetimore mund t'i ofrojnë një shërbim të vlefshëm Këshillit, misioni i të cilit është të ruajë besimin e publikut në gjyqësor, përmes llogaridhënies profesionale.

PJESA 2: PASQYRË E PROCESIT DISIPLINOR

Korniza Ligjore e Sistemit Disiplinor Gjyqësor të Kosovës - Hetimet Disiplinore

Korniza ligjore për sistemin disiplinor gjyqësor të Kosovës përbëhet nga burimet vijuese:

- Ligji Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve
- Ligji Nr. 05/L -003 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve;
- Rregullorja e Këshillit Gjyqësor të Kosovës Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve;
- Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Gjyqtarëve;
- Kodi i Procedurës Penale (KPP); dhe,
- Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Ligji dhe Rregullorja e Këshillit rregullojnë kryesisht procedurën e hetimit disiplinor gjyqësor. Sa i përket ligjit, neni 12 (procedura e hetimit) dhe neni 13 (Marrëveshja vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore) rregullojnë hetimin e çështjeve disiplinore. Neni 14 i Rregullores (veprimet procedurale të Panelit Hetimor) ofron udhëzime procedurale për Panelet Hetimore, të cilat plotësojnë nenet 12 dhe 13 të Ligjit.

Neni 12(8) i Ligjit parasheh se KPP-ja vlen *mutatis mutandis* për mbledhjen e provave (faza e hetimit) dhe lidhur me të drejtat e subjektit të hetimit. Neni 14 (3) i Rregullores përfshin nenin 12(8) të Ligjit me referencë.

Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (PPA) zbatohet ngushtësisht në rastin e transferimit të një ankese disiplinore nga autoriteti jokompetent tek Autoriteti Kompetent, sipas nenit 9 të Ligjit (ankesat kundër gjyqtarëve për shkelje disiplinore).

Neni 5 (Shkeljet disiplinore për gjyqtarë) i Ligjit rendit bazat e shkeljeve disiplinore nga gjyqtarët. Neni 5 parasheh që shkelja e detyrave të gjyqtarit, qoftë nëse bëhet nga gjyqtari me dashje ose me neglizhencë të rëndë, është bazë për shkelje disiplinore. Neni 5 rendit gjashtëmbëdhjetë (16) shkelje disiplinore. Neni 2 (2.11) rendit si bazë për shkelje disiplinore rastin kur gjyqtari me dashje ose nga pakujdesia e rëndë "kryen ndonjë funksion, detyrë ose shërbim, merr ndonjë përgjegjësi ose angazhohet në ndonjë aktivitet, kandidon ose zgjidhet në ndonjë funksion apo detyrë që është në kundërshtim me detyrat e gjyqtarit sipas Kushtetutës, Ligjit për Gjykatat dhe Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë". Kështu, neni 2.11 citon kështu burime plotësuese juridike të cilat mund të jepen si baza të shkeljes gjyqësore.

Procesi i sistemit disiplinor gjyqësor - Panelet Hetimore / Procedura

Në përgjithësi, sistemi disiplinor gjyqësor i Kosovës mund të ndahet në tre faza:

- Faza 1: Parashtrimi dhe shqyrtimi i ankesës;
- Faza 2: Hetimi;
- Faza 3: Procedura disiplinore.

Faza 1, përfshin pranimin dhe shqyrtimin e ankesës nga Autoriteti Kompetent. Nëse Autoriteti Kompetent beson se ka bazë të arsyeshme të dyshimit se është kryer një shkelje disiplinore,

atëherë duhet të kërkojë nga Këshilli të fillojë hetimin, gjë që inicion edhe krijimin e Panelit Hetimor. Hetimi nuk ka asnjë rol në procedurat e Fazës 1.

Faza 2, është faza e procedurës hetimore, që ushtrohet nga Paneli Hetimor. Paneli duhet të kryejë hetimet brenda tre (3) muajsh, përveç nëse periudha e hetimit zgjatet nga Këshilli, me kërkesë të Panelit. Periudha e zgjatjes nuk mund të jetë më shumë se dy muaj. Pas përfundimit të hetimit, Paneli duhet të paraqesë raport me shkrim tek Këshilli, duke dokumentuar gjendjen faktike dhe provat e mbledhura ose, përndryshe, të dorëzojë marrëveshjen vullnetare midis Panelit Hetimor dhe subjektit të hetimit, që pranon faktet dhe shkeljet disiplinore. Marrëveshja e tillë duhet të përfshijë sanksionin e dakorduar disiplinor. Pas dorëzimit të raportit të hetimit me shkrim, ose marrëveshjes për zgjidhje vullnetare, funksioni i Panelit Hetimor pushon, sipas vendimit të Këshillit që e referon çështjen disiplinore tek Paneli Hetimor për veprime të mëtejshme.

Faza 3, është faza formale disiplinore, e cila zhvillohet nga Këshilli. Neni 14 parasheh që "palët në procedurë ftohen të marrin pjesë në seancën e Këshillit." Gjatë fazës 3, Këshilli mban seancën, ku Kryetari i Panelit Hetimor dhe subjekti i hetimit prezantojnë argumentet e tyre të rastit disiplinor.

Shtojca 2, përmban grafikët e sistemit disiplinor:

- Sistemi Disiplinor Gjyqësor (Tri Faza);
- Hapat e Procedurës hetimore.

PJESA 3: STANDARDET DHE PRAKTIKA NDËRKOMBËTARE - SISTEMET DISIPLINORE

Materiali burimor praktik i rekomanduar për procedurat disiplinore gjyqësore përfshin si vijon:

- Doracaku për Anëtarët e Komisioneve të Etikës Gjyqësore, Qendra Kombëtare për Gjykatat e Shtetit, Qendra për Etikën Gjyqësore (Mars 2020);
- Libri procedural i Disiplinës Gjyqësore, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial i Bosnjës e Hercegovinës (shtator 2019);
- Doracaku për Hetimin Disiplinor të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në Shqipëri (korrik 2017);
- Doracaku i Këshillit Gjyqësor/Prokurorial të Kosovës për hetimin e rasteve të shkeljeve disiplinore, që kryhet nga Zyra e Prokurorit Disiplinor (Qershor 2013).

Për informata gjithëpërfshirëse mbi standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mira që kanë të bëjnë me sistemet disiplinore gjyqësore, *shih Shtojcën 3*, e cila përmban informatat e marra nga Libri Procedural Disiplinor i Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial të Bosnjës dhe Hercegovinës.

PJESA 4: PROCEDURA PARA-HETIMORE

A. Referencat ligjore

Ligji Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Ligji), rregullon hetimin e ankesave për sjellje të supozuara të pahijshme profesionale. Në mënyrë të veçantë, Kapitulli III rregullon ankesat, hetimet dhe procedurat disiplinore. Neni 12 (Procedura e Hetimit) rregullon procedurën e hetimit dhe përmban 11 paragrafë.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka miratuar Rregulloren për Procedurën Disiplinore për Gjyqtarë (Rregullorja), të datës 27 maj 2019. Ka disa nene të Rregullores që vlejné për fazat para-hetimore dhe hetimore të ankesës, si vijon:

Neni 6 Shqyrtimi fillestar nga Autoritetit Kompetent;

Neni 7 Veprimet e Kryetarit pas shqyrtimit fillestar;

Neni 8 Kërkesa për Fillimin e Hetimit;

Neni 9 Pranimi dhe Regjistrimi i Kërkesës për fillimin e hetimeve në Këshill dhe ankesa;

Neni 10 Shqyrtimi i kërkesës për fillim të hetimeve;

Neni 12 Themelimi i Panelit Hetimor;

Neni 14 Veprimet procedurale të Panelit Hetimor;

B. Procedura

1. Faza para-hetimore

Afati kohor: 30 ditë nga pranimi i ankesës

Neni 9 i Ligjit dhe nenet 6 dhe 7 të Rregullores përqendrohen në shqyrtimin fillestar të ankesës nga Autoriteti Kompetent për të vendosur nëse ka baza të arsyeshme (Ligji 12 (2)) për të besuar që gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, si dhe sipas rrethanave, të kërkojë nga Këshilli të fillojë hetimin e gjyqtarit. Gjatë kësaj faze, Autoriteti Kompetent mund të mbledhë informata nga ankuesi ose subjekti i hetimit. Procedura para-hetimore është si më poshtë:

Hapi 1. Shqyrtimi i Ankesës nga Autoriteti Kompetent

Ligji: Neni 9; Rregullorja: Neni 6;

- 1.1 Autoriteti Kompetent shqyrton ankesën (dhe përfundon procedurat e fazës para-hetimore) **brenda tridhjetë (30) ditëve** nga pranimi i ankesës. (Ligji 9 (6); Rreg. 6 (1)).
- 1.2 Autoriteti Kompetent mund të kërkojë informacion nga ankuesi **brenda tetë (8) ditëve** nga pranimi i ankesës, nëse ankesa nuk është e qartë, është e mangët, ose përmban informata të papërcaktuara. (Rreg. 6(2))
- 1.3 Autoriteti Kompetent mund të kërkojë deklaratë nga subjekti i hetimit. (Rreg. 6(4))
 - **Shënim:** Ligji dhe Rregullorja lejojnë, por nuk obligojnë Autoritetin Kompetent të kërkojë deklaratë nga subjekti i hetimit gjatë fazës para-hetimore. Autoriteti Kompetent i lejohet të grumbullojë prova dhe shkresa të disponueshme në këtë fazë, por jo të intervistojë dëshmitarë. Përrjashtimisht, nëse Autoriteti Komptenet ka ndonjë brengë që hetimi mund të dëmtohet nga kontakti me subjektin e hetimit para se të intervistohen dëshmitarët dhe të mblidhen provat, subjektit të hetimit nuk duhet t'i kërkohet deklaratë në këtë kohë.

Hapi 2. Shqyrtimi i Provave nga Autoriteti Kompetent dhe Vendimi

Ligji: Neni 9; Rregullorja: Nenet 6, 7, 8;

- 2.1 Autoriteti Kompetent shqyrton informatat - ankesën, deklaratën e subjektit të hetimit dhe dokumentet e tjera në dispozicion dhe vendos për veprime të mëtejshme.
- Shënim: Nëse shkelja e supozuar disiplinore përmban elemente të veprës penale, Autoriteti Kompetent duhet t'ia referojë çështjen prokurorit të shtetit dhe të njoftojë Këshillin. (Rreg. 6 (5)) Referimi i çështjes tek prokurori pezullon procedurën disiplinore. (Rreg. 6 (6)) Procedura disiplinore rifillon pas vendimit të plotfuqishëm të prokurorit ose gjykatës. (Rreg. 6(9))
- 2.2 Autoriteti Kompetent hedh poshtë ose refuzon ankesën nëse është joserioze, e pabazuar, ose nuk ka të bëjë me shkelje disiplinore ose është parashkruar (Ligji, 9 (6)) ose kërkon fillimin e hetimit. (Ligji, 9 (6); Rreg. 8 (1))
- Shënim: Autoriteti Kompetent hedh poshtë ankesën nëse ankesa është anonime ose shkelja e pretenduar është parashkruar; për shembull, e papranueshme për shkak të parashkrimit. (Rreg. 7(2))
 - Shënim: Autoriteti Kompetent refuzon ankesën nëse ajo është dukshëm joserioze (ankesë joserioze) ose e pabazuar. (Rreg. 7(2))

Hapi 3. Autoriteti Kompetent kërkon nga Këshilli të fillojë hetimin disiplinor

Ligji: Nenet 9, 12; Rregullorja: Nenet 7, 8;

- 3.1 Autoriteti Kompetent kërkon nga Këshilli fillimin e hetimeve disiplinore mbi bazën e një ankese të paraqitur nga një person fizik apo juridik, e cila nuk është hedhur poshtë drejtpërdrejt sepse është joserioze, e pabazuar, nuk përbën shkelje disiplinore ose është parashkruar (sipas ligjit, 9 (6)).
- 3.2 Kërkesa për fillimin e hetimit i paraqitet me shkrim Këshillit dhe subjektit të hetimit (Ligji, Neni 1 (4); Rreg. 8 (4)).
- 3.3 Kërkesa për hetim duhet të përmbajë elementet vijuese (Ligji, 12(4); Rreg. 8(3)):
- (a) Identitetin e gjyqtarit që do të hetohet;
 - (b) Përshkrimin e saktë të aspekteve faktike dhe juridike mbi të cilat është ngritur dyshimi për shkelje disiplinore;
 - (c) Propozimin për shqiptimin e masës disiplinore në përputhje me ligjin;
 - (d) përshkrim të saktë të veprimeve të ndërmarra nga Autoriteti Kompetent;
 - (e) deklaratat e palëve ose provat eventuale të mbledhura gjatë fazës së shqyrtimit fillestar.
- Shënim: Autoriteti Kompetent mund të kërkojë nga Këshilli, sipas detyrës zyrtare, të fillojë hetimin kur ka baza të arsyeshme të besojë se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore (Rreg 8 (2)).
 - Shënim: Në një rën anë, pasi që shqyrtimi i ankesës është fazë fillestare, nuk është në përputhje me praktikën e mira të rekomandohet masa disiplinore në këtë fazë, sepse qëllimi i fazës pasuese të hetimit është të përcaktojë faktet si dhe nëse ekziston baza faktike për të konkluduar se është kryer shkelje disiplinore. Mbledhja e provave nga Paneli Hetimor do të zhvillojë më tej të dhënat faktike që janë relevante për kryerjen e shkeljes disiplinore dhe sanksionin përkatës. Autoritetit Kompetent i mungon baza e mjaftueshme faktike për të bërë propozimin në lidhje me sanksionin disiplinor, pra është praktikë më e mirë që Autoriteti Kompetent të përcaktojë nëse ekziston baza faktike për t'a kërkuar e hetuar, gjë që është qëllimi kryesor. Vetëm në rrethanat kur faktet para Autoritetit Kompetent janë të pakontestueshme dhe vërtetojnë shkeljen disiplinore, Autoriteti Kompetent duhet të marrë parasysh

propozimin e masës disiplinore. Në anën tjetër, autoriteti kompetent normalisht duhet të ketë njohuri për sjelljen dhe veprimet e subjektit të hetimit, që mund të jetë relevante dhe të jetë e dobishme për Panelin Hetimor. Në rastin e tillë, qëndrimet fillestare të Autoritetit Kompetent në lidhje me masën e propozuar disiplinore mund të jetë me interes për Panelin Hetimor, sidomos nëse Paneli Hetimor dhe subjekti i hetimit duan të lidhin marrëveshje vullnetare për shkeljen e supozuar, e cila përfshin masë të propozuar disiplinore.

2. Autoriteti Kompetent njofton ankuesin, subjektin e hetimit dhe Këshillin për vendimin për hedhjen poshtë ose refuzimin e ankesës, ose për kërkesën për fillimin e hetimit (Ligji, 9 (6); Rreg 7 (4), 8 (4)).
 - Shënim: Afati i fundit për të përfunduar Hapat 1-3 është **tridhjetë (30) ditë** pas pranimit të ankesës. (Ligji, 9(6))
 - Shënim: Mosrespektimi i afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga Autoriteti Kompetent (Kryetari i Gjykatës) përbën shkelje disiplinore. (Ligji, 9(7))

2. Faza e themelimit të Panelit Hetimor

Afati kohor: 15 ditë nga pranimi i kërkesës për fillimin e hetimit nga Autoriteti Kompetent

Neni 12(5) i Ligjit dhe nenet 10 - 12 të Rregullores përmbajnë dispozita që përcaktojnë themelimin e Panelit Hetimor, i cili është baza për hetimin e ankesës kundër një gjyqtari. Sipas Ligjit, neni 12(5), Paneli Hetimor përbëhet nga tre (3) gjyqtarë në procedurë disiplinore lidhur me gjyqtarin që është subjekt i hetimit. Paneli Hetimor nuk mund të përfshijë gjyqtarë nga gjykata e subjektit të hetimit disiplinor. Këshilli emëron kryetarin e Panelit Hetimor. Sipas Nenet 12 të Rregullores, Këshilli cakton dy anëtarë rezervë për secilin Panel Hetimor. Paneli mund të përkrahet nga zyrtarët e Këshillit për të siguruar ndihmë profesionale dhe administrative, duke respektuar edhe kufizimet e konfliktit të interesit. Neni 11 i Rregullores parasheh listën e gjyqtarëve nga e cila Këshilli zgjedh anëtarët e Paneleve Hetimore. Procedura e themelimit të Panelit Hetimor është si më poshtë:

Hapi 1. Këshilli shqyrton Kërkesën për fillimin e hetimit dhe Vendimin

Ligji: Neni 12; Rregullorja: Nenet 10 – 12;

1.1 **Brenda perëmbdhjetë (15) ditëve** nga pranimi i kërkesës nga Autoriteti Kompetent për të filluar hetimin, Këshilli shqyrton kërkesën dhe themelon Panelin Hetimor. (Ligji, 12 (5); Rreg. 10 (3)).

- Shënim: Këshilli mund të pranojë, refuzojë ose miratojë kërkesën për fillimin e hetimit, të paraqitur nga Avokati i Popullit në përputhje me nenin 12 (3) të Ligjit. (Rreg. 10 (4))
- Shënim: Ligji dhe Rregullorja nuk përcaktojnë shprehimisht që Këshilli mund të refuzojë kërkesën për hetime nga Autoriteti Kompetent, mund të konkludohet se Këshilli në natyrë ka autoritetin për të refuzuar kërkesën për fillimin e hetimit.

Hapi 2. Këshilli themelon Panelin Hetimor

Ligji: Neni 12; Rregullorja: Nenet 10, 11, 12;

2.1 Nëse Këshilli miraton kërkesën, Këshilli cakton anëtarët e Panelit Hetimor në përputhje me (Ligji, 12 (5); Rreg. 10(3)).

- Shënim: Këshilli emëron tre (3) anëtarë dhe dy (2) anëtarë rezervë për secilin Panel Hetimor. Paneli mund të përfshijë të paktën një anëtar me ekspertizë në fushën gjyqësore të subjektit të hetimit. Këshilli emëron kryetarin e Panelit Hetimor. (Rregullorja, Neni 12)
- Shënim: Në rastet kur Paneli Hetimor është duke hetuar subjektin e hetimit në çështje disiplinore, është praktikë e mirë të merret parasysh referimi i një ankesë të re disiplinore tek Paneli Hetimor ekzistues, sidomos nëse bashkimi i ankesave disiplinore promovon drejtësinë apo efikasitetin në kryerjen e hetimeve ndaj subjektit të hetimit. Ligji nuk ia ndalon Këshillit që të referojë më shumë se një ankesë tek Paneli Hetimor. Bashkimi i disa ankesave tek një Panel Hetimor mund të ketë kuptim në rastet kur një Panel Hetimor i vetëm mund të hetojë efektivisht disa ankesa apo pretendime, duke shmangur kështu rastin në të cilin disa panele do të hetonin një gjyqtar njëkohësisht.

PJESA 5: PROCEDURA HETIMORE

1. Faza hetimore:

Afati kohor: tre (3) muaj nga data e themelimit të Panelit Hetimor (me mundësinë e zgjatjes nga Këshilli, që nuk kalon dy (2) muaj).

A. Referencat ligjore

Neni 12 i Ligjit dhe neni 14 i Rregullores përqendrohen në procedurat e fazës së hetimit që zbatohen nga Paneli Hetimor. Paneli Hetimor është përgjegjës të mbledhë informata dhe prova, të njëjtat t'ia paraqes subjektit të hetimit, t'i përgjigjet pretendimeve të sjelljes së pahijshme dhe t'i paraqesë raportin me shkrim Këshillit, duke shtjelluar gjetjet e tij. Pas dorëzimit të raportit tek Këshilli, funksioni i Panelit Hetimor pushon kur çështja bëhet përfundimtare.

Neni 12(11) i ligjit parasheh që Kodi i Procedurës Penale (KPP) zbatohet *mutatis mutandis* për grumbullimin e provave dhe të drejtat e personave nën hetim. Kështu, zbatimimi *mutatis mutandis* i KPP-së është më relevant në mbrojtjen e të drejtave të subjektit të hetimit në proces të rregullt ligjor në lidhje me njoftimin me akuzat, të drejtën e qasjes/shqyrtimit të provave, për paraqitjen e provave, për t'u dëgjuar dhe për t'u përfaqësuar nga avokati mbrojtës. Derisa të drejtat e subjektit të hetimit janë kodifikuar në Rregullore, neni 14 (1), gjatë kryerjes së hetimeve, Panelet e Hetimore duhet të kujdesen veçanërisht për dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që theksojnë të drejtat e palës së akuzuar (d.m.th. gjyqtari që është subjekt i hetimit). Shih edhe Pjesën 7 - Të Drejtat e subjektit të hetimit në proces të rregullt.

B. Procedura

Procedura hetimore është si më poshtë:

Hapi 1. Paneli Hetimor njofton Subjektin e Hetimit për Procedurën e Hetimit Rregullorja, neni 14;

- 1.1 Paneli Hetimor e njofton subjektin e hetimit me shkrim për kryerjen e hetimit. Neni 14 i Rregullores kërkon që njoftimi me shkrim të përfshijë informatat vijuese:
 - (1) Shkelja e supozuar për të cilën gjyqtari hetohet;
 - (2) Përbërja e Panelit Hetimor;
 - (3) E drejta për t'u dëgjuar në lidhje me ankesën;
 - (4) E drejta e qasjes së plotë në dosjen disiplinore;
 - (5) E drejta për t'u dëgjuar në lidhje me hetimet;
 - (6) E drejta për të paraqitur prova, dokumente ose dëshmitarë;
 - (7) Të drejtën për t'u informuar rreth zgjerimit të hetimeve;
 - (8) E drejta për t'u përfaqësuar nga avokati mbrojtës gjatë procedurës disiplinore.
- 1.2 Neni 12 (6) i Ligjit parasheh që subjekti i hetimit mund të propozojë dëshmitarë, të paraqesë prova dhe të kërkojë dorëzimin e dokumenteve dhe provave që mbahen nga persona ose institucione të tjera. Letra e njoftimit me shkrim e panelit duhet të përmbajë referencën sipas nenit 12 (6) të Ligjit si përforcim i kritereve të njoftimit sipas nenit 14.

Hapi 2. Paneli i Hetimit kryen hetimet Ligji, neni 12; Rregullorja Neni 14;

- 2.1 Neni 14 i Rregullores parasheh që Paneli Hetimor të zhvillojë hetimin në përputhje me nenin 12 (6) - (11) të Ligjit.
- 2.2 Neni 12 (6) i Ligjit parasheh që subjekti i hetimit dhe Autoriteti Kompetent mund të propozojnë dëshmitarë, të paraqesin prova dhe të kërkojnë dorëzimin e dokumenteve dhe provave që mbahen nga persona ose institucione të tjera.
- 2.3 Neni 12 (7) i Ligjit parasheh që Paneli Hetimor t'i japë subjektit të hetimit mundësinë të dëgjohet dhe të përfaqësohet nga avokati mbrojtës. Për më tepër, subjekti i hetimit duhet të ketë qasje në të gjitha provat e mbledhura nga Paneli Hetimor, të cilat mund të paraqiten afër mbylljes së hetimit, kur Paneli do të intervistojë subjektin e hetimit.
- 2.4 Neni 14(4) i Rregullores parasheh që Paneli i Hetimor të njoftojë Këshillin dhe të kërkojë miratimin për zgjerim të hetimit nëse konstaton se subjekti i hetimit ka kryer shkelje të tjera disiplinore.
- 2.4 Neni 12(8) i Ligjit parasheh që Paneli Hetimor do të përfundojë hetimin brenda tre (3) muajve pas themelimit të tij.
- 2.5 Neni 14 i Rregullores parasheh që Paneli Hetimor paraqet raport me shkrim për gjendjen faktike dhe prova tek Këshilli, subjektit të hetimit dhe Autoritetit Kompetent që ka kërkuar hetimin.
 - Shënim: Shkresa e raportit me shkrim nga Paneli Hetimor tek Këshilli, subjekti i hetimit, si dhe Autoriteti Kompetent duhet të ofrojë këshillën juridike për të drejtën e qasjes në shkresa të rastit si dhe në prova që janë mbledhur nga Paneli Hetimor. (Rreg. 14(5))
 - Shënim: Në rrethana të jashtëzakonshme, Këshilli mund të zgjasë periudhën e hetimit për dy (2) muaj shtesë, me kërkesë të Panelit Hetimor. (Ligji, 12 (6); Rreg. 12 (3))
- 2.6 Bazuar në nenin 2, të Ligjit Nr.08/L-003 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, gjatë procedurës hetimore, Këshilli ex officio ose me kërkesë të Autoritetit Kompetent i cili ka kërkuar fillimin e hetimeve, mund të suspendojë gjyqtarin ose prokurorin i cili është nën hetime nëse një gjë e tillë është e nevojshme duke marrë parasysh seriozitetin e shkeljes së supozuar disiplinore dhe të sigurohet integriteti dhe efektiviteti i hetimeve”

C. Komente

Dispozitat e Ligjit dhe Rregullores ofrojnë udhëzime të rëndësishme, por të kufizuara mbi atë se si Paneli Hetimor duhet që në praktikë të kryejë hetimin. Ndërsa procedura e hetimit e përshkruar më sipër duhet të ndiqet nga Paneli i Hetimor, ekziston nevoja të vendosen praktika të mira që plotësojnë boshllëqet në të, si dhe përforcojnë punën e Panelit Hetimor dhe procedurës hetimore. Boshllëqet e vrojtuar në Ligj dhe Rregullore janë:

- Ligji dhe Rregullorja nuk specifikojnë ndonjë procedurë për të siguruar që subjektit të hetimit i është dhënë mundësi efektive për t'u dëgjuar. Subjektit të hetimit duhet t'i sigurohet qasja në shkresat e rastit dhe provat e mbledhura nga Paneli Hetimor; megjithatë, nuk është specifikuar se në cilën fazë të procesit hetimor mund të ketë qasje në shkresat e rastit dhe provat e mbledhura.
- Ligji dhe Rregullorja janë të heshtura lidhur me atë se si Paneli Hetimor duhet të kërkojë dorëzimin e dokumenteve nga institucionet ose personat jashtë gjyqësorit. Procesi disiplinor nuk është procedurë penale, si dhe është më i ngjashëm me procedurën civile

apo administrative. Për këtë arsye, zbatimi i KPP-së *mutatis mutandis* në procedurë disiplinore ka vlerë të kufizuar në sigurimin e dokumenteve nga institucionet jashtë gjyqësorit, si dhe deklaratat nga dëshmitarët si palë e tretë.

- Dispozitat e KPP-së që sigurojnë të drejtat e subjektit të hetimit si palë e akuzuar janë, megjithatë, me rëndësi. Shih Pjesën 6 - Të Drejtat e subjektit të hetimit në proces të rregullt.
- Ligji dhe Rregullorja nuk specifikojnë mjaftueshëm procedura për njoftimin e subjektit të hetimit në faza të ndryshme të hetimit, si për shembull, se kur Paneli Hetimor i kërkon Këshillit të zgjerojë fushëveprimin e hetimit ose të zgjasë periudhën e hetimit.
- Siç parashihet me Ligj dhe Rregullore, Paneli Hetimor duhet të dorëzojë raport me shkrim që specifikon faktet dhe provat e mbledhura gjatë procedurës disiplinore; megjithatë, nuk ka udhëzime në lidhje me përmbajtjen e raportit të Panelit Hetimor.
- Ligji dhe Rregullorja nuk përcaktojnë ndonjë standard të qartë të provave për të orientuar Panelin Hetimor në përcaktimin se cili nivel i provave është i mjaftueshëm për të nxjerrë konstatimin faktik se shkelja disiplinore është kryer apo nuk është kryer.
- Ligji dhe Rregullorja nuk ndalojnë Panelin Hetimor nga përfshirja e një rekomandimi për sanksionin disiplinor në raportin hetimor të paraqitur në Këshill, rekomandimin për sanksionin disiplinor, edhe pse ekziston praktika e ofrimit të rekomandimit në raportin e hetimit. Për më tepër, Paneli Hetimor duhet të propozojë sanksionin disiplinor, nëse Paneli dhe subjekti i hetimit lidhin marrveshje vullnetare sipas nenit 13 të Ligjit. Për të qenë konsistentë, ka kuptim që Paneli të rekomandojë sanksionin disiplinor kur konstaton se ka pasur shkelje disiplinore. Rekomandimi i Panelit nuk është detyrues, si dhe ofrohet vetëm si sugjerim për trajtim nga Këshilli.
- Një parim i përgjegjësisë disiplinore është proporcionaliteti (Ligji, neni 3); megjithatë, nuk ka kritere zyrtare për përcaktimin e rrethanave rënduese dhe lehtësuese, për të orientuar Panelin Hetimor drejt rekomandimit të arsyetuar për sanksionin disiplinor, bazuar në faktet e mbledhura. Duke pasur parasysh numrin e Paneleve Hetimore, anëtarësia e të cilëve kufizohet deri në tri (3) vjet, ekzistojnë gjasa të mëdha që Panelet Hetimore të mos jenë uniforme në qasjen e tyre të rekomandimit të sanksioneve disiplinore tek Këshilli, duke krijuar pabarazi në trajtimin e subjekteve të hetimit për shkelje të ngjashme disiplinore, qoftë nëse Këshilli pranon rekomandimin e Panelit Hetimor, ose Paneli Hetimor dhe subjekti i hetimit lidhin marrëveshje vullnetare. Shih Pjesën 7, Marrëveshja Vullnetare për Rastin Disiplinor.

D. Rekomandimet si Praktika të Mira

Për të përforcuar procedurën e hetimit të përcaktuar në Ligj dhe Rregullore, Panelet Hetimore mund të zbatojnë praktika të mira në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren për të mbushur boshllëqet dhe për të promovuar procedurë më uniforme të hetimit. Neni 12 i Ligjit jep autorizime të gjera për kryerjen e procedurës së hetimit; kështu, herë pas here, Këshilli mund të ndryshojë Rregulloren për të formalizuar praktikën e mira dhe për të promovuar uniformitetin, si dhe për të zhvilluar databazë/buletin të praktikës gjyqësore për rastet disiplinore që përbëjnë praktika të mira.

Kjo nën-pjesë përmban praktika të mira që mund të orientojnë Panelin Hetimor në kryerjen e hetimit. Praktikën e mira janë këshillues dhe nuk kanë për qëllim të zënë vendin e Ligjit apo Rregullores.

Njoftimi me shkrim për fillimin e procedurës hetimore

Neni 14 i Rregullores specifikon që Paneli Hetimor duhet të njoftojë subjektin e hetimit për hetimin disiplinor. Njoftimi duhet të përmbajë informata në lidhje me pretendimet dhe përbërjen e panelit, si dhe të këshillojë subjektin e hetimit për të drejtat e parapara me nenin 14(1). Ligji dhe Rregullorja nuk përcaktojnë ndonjë afat kohor për njoftimin e subjektit të hetimit. Neni 14 (1.7) i Rregullores parasheh se subjekti i hetimit ka të drejtë të përfaqësohet nga avokati mbrojtës gjatë procedurave disiplinore. Neni 14(2) parasheh që nëse subjekti i hetimit angazhon avokat mbrojtës, për këtë duhet ta njoftoj Panelin Hetimor. Neni 12(7) i Ligjit përforcon të drejtën e subjektit të hetimit në përfaqësim nga avokati mbrojtës. Neni 152(4) i KPP-së rregullon kryerjen e shqyrtimit paraprak të pandehurit, si dhe parasheh që i pandehuri ka të drejtë të konsultohet me avokatin mbrojtës para dhe gjatë marrjes në pyetje.

- Një praktikë e mirë është që Paneli Hetimor të njoftojë subjektin e hetimit **brenda dhjetë (10) ditëve** nga data e themelimit të Panelit Hetimor, ashtu që subjekti i hetimit të njoftohet me kohë për pretendimet dhe të drejtat e procesit të rregullt ligjor. *Shih Formularin Standard (FS) 1, Njoftimi për Procedurë Hetimore (subjekti i hetimit) në Shtojcën 1.*
- Shënim: Duhet të shqyrtohet nëse njoftimi i subjektit të hetimit përbën rrezik për mbledhjen e provave. Nëse përbën rrezik, atëherë Paneli Hetimor mund të marrë parasysh të mos njoftojë subjektin e hetimit në kohën kur Paneli interviston dëshmitare dhe mbledh prova që rrezikohen.
- Një praktikë e mirë është që letra e njoftimit të informojë subjektin e hetimit për të drejtën e përfaqësimit gjatë fazës së hetimit dhe që në përputhje me nenin 14(2) të Rregullores, Paneli Hetimor duhet të njoftohet me shkrim për përfaqësimin me prkurë, ose nga subjekti i hetimit ose nga avokati mbrojtës i subjektit të hetimit.
- Një praktikë e mirë është që, sipas nenit 12 (6) të Ligjit, letra e njoftimit t'a këshillojë subjektin e hetimit që ai mund të propozojë dëshmitarë, të paraqesë prova dhe të kërkojë dorëzimin e dokumenteve dhe provave që mbahen nga persona ose institucione të tjera, sipas një afati të caktuar.
- Një praktikë e mirë është që letra e njoftimit të kërkojë që subjekti i hetimit të parashtojë vullnetarisht përgjigjen fillestare me shkrim ndaj pretendimeve për shkeljen disiplinor **brenda dhjetë (10) ditëve** nga data e letrës. Përgjigja fillestare nga subjekti i hetimit mund të ndihmojë hetimin në kuptimin e vlerësimit të bazave të pretendimeve, si dhe nevojën për hetime të mëtejshme.
- Ligji dhe Rregullorja nuk kërkojnë nga Paneli Hetimor të njoftoj ankuesin se ka filluar hetimi. Është praktikë e mirë që Paneli Hetimor të dërgojë një letër njoftimi tek ankuesi. *Shih FS 2, Njoftimi për Procedurë Hetimore (Ankuesi) në Shtojcën 1.*

Plani i hetimit

Periodha kohore për kryerjen e hetimit disiplinor është e kufizuar, gjë që kërkon veprim të shpejtë nga Paneli Hetimor. Neni 12(6) i Ligjit parasheh që Paneli Hetimor të vërtetojë faktet dhe të mbledhë prova në lidhje me shkeljen e supozuar disiplinore. Paneli Hetimor duhet të përfundojë hetimin brenda tre (3) muajve nga formimi i tij. Këshilli mund të zgjasë hetimet për një periudhë shtesë prej dy (2) muajsh në rrethana të jashtëzakonshme. Duke pasur parasysh periudhën e kufizuar kohore, është me rëndësi që Paneli Hetimor në mënyrë metodike të planifikojë punën e tij në mbledhjen e provave, në marrjen e deklaratave të dëshmitarëve, si dhe në ofrimin e mundësisë për subjektin e hetimit që t'i përgjigjet pretendimeve dhe provave me shkrim dhe/ose gojarisht gjatë fazës së hetimit.

- Një praktikë e mirë është që Paneli Hetimor të përgatisë një plan hetimi, i cili përmban:
 - (1) përmbledhje të pretendimeve të ankesës;
 - (2) listë të provave që do të mbledhen dhe afatet përkatëse;
 - (3) listë të personave që do të intervistohen, dhe
 - (4) datën në të cilën mund të caktohet intervista, ashtu që subjektit të hetimit t'i jepet mundësi e plotë e përgjigjes ndaj pretendimeve dhe e sigurimit të provave tjera (para intervistës, subjekti i hetimit ose avokati mbrojtës i tij duhet të kenë qasje në shkresat e rastit të Panelit Hetimor dhe provat e mbledhura).
- Një praktikë e mirë është që Paneli Hetimor të përfshijë Zyren për Disiplinë e cila vepron në kuadër të Njesisë për Inspektim Gjyqësor në Këshill në formulimin e Planit të Hetimit, për të siguruar përkrahje maksimale administrative në kryerjen e hetimeve disiplinore. Më së paku, Këshilli duhet të ketë procedurë të vendosur në kuptimin që Paneli të ketë qasje në shërbime mbështetëse administrative të Këshillit, kur kryen hetime. Plani mund të jetë vegël kyçe e koordinimit ndërmjet Panelit dhe Zyres për Disiplinë. Përgjithësisht, Paneli ndërmerr të gjitha veprimet materiale lidhur me hetimin, siç janë intervistat e dëshmitarëve, vlerësimin e provave, si dhe hartimin e raportit të hetimit. Çështjet administrative, si njoftimet për palët, caktimin e takimeve, si dhe transkriptimi i dokumenteve mund të merren përsipër nga Zyra për Disiplinë e cila vepron në kuadër të Njesisë për Inspektim Gjyqësor në Këshill.
- *Shih FS3, Plani i Hetimit, në Shtojcën 1.*

Kryerja e hetimit

Paneli Hetimor është përgjegjës për kryerjen e hetimit disiplinor në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren (shih procedurën e hetimit të përshkruar më lart). Gjatë përgatitjes së planit të hetimit, anëtarët e panelit duhet të ndajnë përgjegjësitë dhe detyrat, si dhe të koordinohen me stafin administrativ të Këshillit në caktimin dhe organizimin e intervistave, si dhe mundësimin e kërkesave për mbledhje të provave. Ndërsa Ligji dhe Rregullorja parashohin që Paneli Hetimor kryen hetimin, nuk specifikojnë se çfarë provash duhen mbledhur, e as mënyrën e mbledhjes së provave. Duke pasur parasysh mungesën e procedurës, këshillohet që Paneli Hetimor të përdorë procedurat standarde të mbledhjes së provave në raste disiplinore, posaçërisht :

- (1) Kërkimi i përgjigjes vullnetare, me shkrim, nga subjekti i hetimit ndaj pretendimeve në ankesë;
- (2) Kërkimi dhe sigurimi i dokumentacionit relevant për hetimin disiplinor;
- (3) Kërkimi dhe sigurimi i deklaratave nga dëshmitarët që kanë njohuri lidhur me pretendimet, dhe
- (4) Intervistimi i subjektit të hetimit për të mbledhur informata, si dhe që subjekti i hetimit të ketë mundësi të përgjigjet ndaj pretendimeve dhe të paraqesë prova.

Neni 12(11) i Ligjit parasheh se KPP-ja vlen *mutatis mutandis* për mbledhjen e provave (si dhe drejtat e subjektit të hetimit). Praktika më e mirë ndërkombëtare është zakonisht që organi gjykues (në këtë rast, Këshilli) ka kompetencë të lëshojë thirrje, me kërkesë të Panelit Hetimor disiplinor, ku obligohet dorëzimi i dokumenteve ose prania e personave të caktuar për të dëshmuar gjatë procedurës formale disiplinore. Si praktikë, Paneli Hetimor duhet të kërkojë të sigurojë dokumente dhe të intervistojë dëshmitarë në baza jo-detyruese. Nëse institucioni ose personi refuzon kërkesën e Panelit Hetimor, Paneli Hetimor mund të ketë nevojë të gjejë mënyra ligjore për të mbledhur provat. Nuk është e qartë nëse zbatimi *mutatis mutandis* i KPP-

së është zgjidhje efektive, apo është më mirë të rishikohet Ligji, si dhe t'i jepet autorizim i drejtpërdrejtë Këshillit ose Panelit të Hetimor që të nxjerrë thirrje obliguese.

Meqenëse afati për hetimin është tre (3) muaj, Paneli Hetimor duhet të zhvillojë hetimin në kohën e duhur. Procesi i sigurimit të provave dhe intervistimit të dëshmitarëve duhet të përqendrohet në elementet kryesore që lidhen me shkeljet e supozuara disiplinore. Për këtë arsye, është e rëndësishme që Paneli Hetimor të përgatisë një plan gjithëpërfshirës të hetimit, si dhe të nisë menjëherë mbledhjen e provave sipas planit të dakorduar nga paneli.

Gjatë procedurës së mbledhjes së informatave dhe provave, anëtarët e Panelit Hetimor duhet të kujdesen për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të mos ndajnë informata konfidenciale lidhur me procedurën disiplinore, siç parashihet me nenin 3 të Rregullores (parimi i fshehtësisë zyrtare).

(1) Kërkimi i përgjigjes vullnetare, me shkrim, nga subjekti i hetimit

Është në interes të Panelit Hetimor të sigurojë përgjigjen fillestare nga subjekti i hetimit sa më shpejt që të jetë e mundur pas fillimit të hetimit. Informatat e hershme nga subjekti i hetimit mund ta ndihmojnë panelin të planifikojë hetimin e tij, të konsolidojë çështjet dhe të identifikojë dëshmitarët për intervistim.

- Një praktikë e mirë është që të kërkohet nga subjekti i hetimit të parashtrojë vullnetarisht përgjigjen fillestare me shkrim ndaj pretendimeve për veprën disiplinore **brenda dhjetë (10) ditëve** nga data e letres. Kërkesa duhet të bëhet në kohën kur i subjekti i hetimit informohet me shkrim nga paneli se ka filluar hetimi. *Shih FS1, Njoftimi për Procedurë Hetimore (subjekti i hetimit) në Shtojcën 1.*
- Një praktikë e mirë është që t'i kërkohet subjektit të hetimit të japë emrat e dëshmitarëve ose dokumentacionin në mbështetje të përgjigjes së subjektit të hetimit.
- Një praktikë e mirë është të jepet përshkrimi i plotë i pretendimeve ose përndryshe, kopja e ankesës nëse nuk ka çështje konfidencialiteti.

(2) Sigurimi i dokumenteve që janë relevante për hetimin disiplinor

Mbledhja e provave duhet të vazhdojë menjëherë pas përfundimit të planit të hetimit. Paneli hetimor duhet të përpiqet të mbledhë dokumentacionin përkatës, mbi bazën e prioritetit, nga institucionet dhe personat. Dokumentacioni që merret që në fazë të hershme të hetimit, e i cili mbështet ose hedh poshtë pretendimet, është i dobishëm në identifikimin e nevojave për dokumentet tjera, apo dëshmitarëve që duhen intervistuar.

- Një praktikë e mirë është që Paneli Hetimor menjëherë të bëjë kërkesat me telefon, faks, email ose postë elektronike për sigurimin e dokumenteve tek institucionet apo personat që posedojnë informatat e kërkuara, pasi të ketë hartuar planin e hetimit. Paneli duhet të kërkojë bindje ndaj kërkesave **brenda dhjetë (10) ditëve** nga data e kërkesës. Përndryshe, paneli mund të kërkojë nga stafi i Këshillit të sigurojë kopje të dokumenteve në vendin ku ruhen ato dokumente. *Shih FS4, Kërkesa e Panelit Hetimor për dokumente, Shtojca 1.*
- Një praktikë e mirë është të kërkohen dokumentet relevante nga subjekti i hetimit, nëse pretendimet kanë të bëjnë me sjelljen, performancën e punës ose rastet e trajtuara nga subjekti i hetimit në detyrë zyrtare në mjedisin e punës.
- Një praktikë e mirë është të regjistrohen në shkresat e rastit disiplinor gjitha dokumentet e siguruar në renditje kronologjike. Kjo siguron edhe shpalosjen e plotë të provave të

mbledhura nga Paneli Hetimor për subjektin e hetimit, nëse subjekti i hetimit kërkon qasje në provat e mbledhura nga paneli.

(3) Marrja e Deklaratave nga Dëshmitarët

Duke pasur parasysh periudhën e kufizuar prej tre (3) muajsh për procesin hetimor, Paneli Hetimor duhet të zbatojë qasje të shumëfishtë për të siguruar marrjen e deklaratave të dëshmitarëve në mënyrë efikase dhe të besueshme. Si një qasje, biseda telefonike me dëshmitarin mund të zbulojë njohuri të drejtpërdrejtë, ose mungesë njohurie, të elementeve të rëndësishme për rastin disiplinor dhe të ndihmojë në përcaktimin nëse personi është dëshmitar i dobishëm. Nëse është kështu, anëtari i Panelit Hetimor mund ta informojë dëshmitarin se paneli do të zhvillojë intervistën me dëshmitarin. Si qasje e dytë, në vend të intervistës fizikisht, deklarata nga dëshmitari mund të merret drejtpërdrejt duke i dërguar pyetje me shkrim dëshmitarit, duke kërkuar përgjigje me shkrim. Si qasje e tretë, paneli mund të marrë një deklaratë të drejtpërdrejtë nga dëshmitari. Intervista fizike duhet të bëhet në vend të sigurt, që është i përshtatshëm për dëshmitarin, për të inkurajuar paraqitjen. Përveç në rrethana të rralla, Paneli Hetimor duhet të zhvillojë intervista individuale të dëshmitarëve, si dhe të mos ketë dëshmitarë të shumtë që intervistohen njëkohësisht në të njëjtën dhomë. Intervista e drejtpërdrejtë, personalisht, duhet të transkribohet ose regjistrohet (audio ose video).

- Një praktikë e mirë është caktimi i intervistave të dëshmitarëve dhe marrja e deklaratave pasi Paneli i Hetimor të ketë mbledhur e shqyrtuar dokumentet përkatëse, si dhe çdo dokument apo deklaratë që jepet nga subjekti i hetimit, nëse jepet vullnetarisht pasi të jetë njoftuar për hetimin. Këto informata fillestare mund të ndihmojnë Panelin Hetimor që të prioritetizojë dhe renditë sigurimin e deklaratave të dëshmitarëve, si dhe qasjet që do të zbatohen në mbledhjen e provave nga dëshmitarët. **Shih FS5 Kërkesa nga Paneli Hetimor për intervistë (dëshmitari).**
- Para marrjes në pyetje të dëshmitarit ose përmes pyetjeve me shkrim ose personalisht, është një praktikë e mirë të udhëzohet dëshmitari që informatat e siguruar nga dëshmitari do të përdoren nga Paneli Hetimor për qëllime të vendosjes nëse është kryer shkelja disiplinore, që procedura e hetimit disiplinor i nënshtrohet konfidencialitetit, si dhe që subjektit të hetimit t'i lejohet qasja në shkresa të rastit dhe provat e panelit hetimor, siç parashihet me Ligj.
- Për deklaratat me shkrim, një praktikë e mirë është të kategorizohen pyetjet sipas fushës tematike ose sipas relevancës për elementet e hetimit apo shkeljen e supozuar disiplinore.
- Para intervistave të drejtpërdrejta me dëshmitarët, është një praktikë e mirë që anëtari i Panelit Hetimor që drejton intervistën të zhvillojë **një listë kontrolli** të çështjeve procedurale dhe hulumtimit të dëshmitarëve për të orientuar procesin e intervistës, përfshirë edhe këshillimin e dëshmitarit që anëtari i Panelit Hetimor përgatit procesverbalin e shkruar të intervistës. **Shih FS6, Lista e Kontrollit për Intervistë (Dëshmitari), në Shtojcën 1.**
- Është praktikë e mirë të sigurohen dëshmitarët dhe të intervistohen dëshmitarët me radhë, pa pasur të tjerë dëshmitarë të pranishëm gjatë intervistës. Kjo masë shmang mundësinë që njëri dëshmitar të ndikojë në deklaratat e një dëshmitari tjetër të pranishëm gjatë intervistës.
- Për intervista të drejtpërdrejta me dëshmitarë, është praktikë e mirë që anëtari përgjegjës i Panelit Hetimor të përgatisë pyetjet paraprakisht. Pyetjet që shtrohen do të varen nga informatat që kërkohen të sigurohen në lidhje me elementet provuese ose përgënjeshtroese të shkeljes disiplinore, ose provave të tjera kryesore. Është praktikë e

mirë që së pari të bëhen pyetje të përgjithshme, të pasuara nga pyetje më konkrete, specifike për secilën fushë të hetimit.

- Nëse dëshmitari refuzon të japë deklaratë ose t'i përgjigjet një pyetjeje specifike, është praktikë e mirë që anëtari i Panelit të Hetimor të njoftojë dëshmitarin për arsyet pse informatat janë të rëndësishme për hetimin. Nëse dëshmitari prapë refuzon të japë informatat, anëtari i Panelit Hetimor duhet ta shënojë këtë informacion në procesverbal.
- Është praktikë e mirë të plotësohet formulari i Dosjes së Intervistës së Dëshmitarit menjëherë pas intervistës së dëshmitarit. Formulari i Dosjes së Intervistës së Dëshmitarëve dokumenton qëllimin e intervistës, fushat e hetimit, dokumentet e paraqitura nga dëshmitari dhe konkluzionet e anëtarit të Panelit Hetimor në lidhje me provat për shkëlqen e supozuar, apo në lidhje me provat tjera. Shih formularin, Dosja e Intervistës së Dëshmitarëve. **Shih FS7, Dosja e Intervistës, në Shtojcën 1.**
- Është praktikë e mirë të regjistrohet intervista e dëshmitarit, me teknologji audio ose video, nëse dëshmitari pajtohet. Dëshmitari duhet të njoftohet për përdorimin e regjistrimit audio ose video para datës së intervistës.

(4) Dhënia e mundësisë për subjektin e hetimit për t'u dëgjuar e për t'u përgjigjur ndaj pretendimeve

Në pajtim me nenin 12 të ligjit, si dhe për të siguruar që subjekti i hetimit të ketë mundësi të plotë dhe efektive për t'u dëgjuar, Paneli Hetimor duhet të caktojë intervistën me subjektin të hetimit afër përfundimit të hetimit. Normalisht, Paneli Hetimor do të ketë nevojë të marrë deklaratën nga subjekti i hetimit, ashtu që t'i mundësohet subjektit të hetimit të përgjigjet ndaj pretendimeve. Paneli Hetimor duhet të kërkojë intervistë personale me subjektin e hetimit. Subjekti i hetimit mund të përfaqësohet nga avokati mbrojtës gjatë intervistës (si dhe në çdo fazë të procesit të hetimit). Gjatë përgatitjes për intervistë me subjektin e hetimit, Paneli Hetimor duhet të orientohet sipas veprimeve dhe praktikave të mira si më poshtë.

- ***Njoftimi i intervistës me subjektin e hetimit.*** Paneli Hetimor duhet t'i dërgojë njoftim me shkrim subjektit të hetimit dhe avokatit mbrojtës të subjektit të hetimit, duke caktuar kohën, datën dhe vendin e intervistës, jo më pak se dhjetë (10) ditë para datës së intervistes, përveç nëse ka rrethana emergjente. Njoftimi me shkrim duhet ta këshillojë subjektin e hetimit se qëllimi i intervistës është t'i ofrojë subjektit të hetimit mundësinë për t'u përgjigjur pretendimeve disiplinore. Njoftimi me shkrim duhet të tregojë që Paneli Hetimor mund të marrë në pyetje subjektin e hetimit për rrethanat në lidhje me pretendimet disiplinore. **Shih FS4, Kërkesa e Panelit Hetimor për Intervistë (subjekti i hetimit): Shtojca 1.**
- ***E drejta e subjektit të hetimit për qasje në provat e mbledhura nga Paneli Hetimor.*** Njoftimi me shkrim duhet të tregojë që subjekti i hetimit ka të drejtë të shqyrtojë shkresat dhe provat e Panelit Hetimor para intervistës dhe që shkresat dhe provat e panelit po ashtu duhet të jenë në dispozicion për qasje në kohën e intervistës. Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë përmbledhjen e pretendimeve që hetohen nga paneli, për t'i dhënë mundësi subjektit të hetimit (avokatit mbrojtës) të përgatisë dëshmi e prova të argumentuara para intervistës.
- ***Intervistimi i subjektit të hetimit.*** Paneli Hetimor duhet të orientohet nga praktikat e mira të përshkruara më sipër për dëshmitarët, përfshirë përgatitjen e **listës së kontrollit** për të drejtuar intervistën me subjektin e hetimit, me regjistrimin e intervistës. **Shih**

FS6, Lista e Kontrollit për Intervistë (deshmitarit), në Shtojcën 1. Në fillim të intervistës, Paneli Hetimor duhet të konfirmojë që subjekti i hetimit e kupton natyrën e pretendimeve disiplinore. Nëse subjekti i hetimit nuk e kupton natyrën e pretendimeve, atëherë Paneli Hetimor duhet të shtjellojë pretendimet disiplinore. Anëtarë i Panelit Hetimor duhet të japë fjalën hyrëse, ku shtjellohet gjendja faktike në rast. Paneli Hetimor duhet të ftojë subjektin e hetimit që t'i përgjigjet pretendimeve disiplinore dhe çështjeve faktike në rast dhe të paraqesë dokumentet në mbështetje të qëndrimit të subjektit të hetimit. Pasi subjekti i hetimit të ketë paraqitur informatat e tij, Paneli Hetimor duhet ta pyesë subjektin e hetimit për fushat ku kërkohen sqarime të gjendjes faktike. Për ta përmbyllur intervistën, Paneli Hetimor duhet të ftojë subjektin e hetimit të japë fjalën përfundimtare. Pas përfundimit të intervistës, Paneli Hetimor duhet të plotësojë formularin e listes së kontrollit për intervistë të subjektit të hetimit.

- *Mundësia e subjektit të hetimit për të paraqitur përgjigje me shkrim ose dokumentacion mbështetës.* Në mbyllje të intervistës, paneli duhet të ftojë subjektin e hetimit të paraqesë një deklaratë përcjellëse me shkrim ose dokumente tjera mbështetëse tek Paneli Hetimor **brenda shtatë (7) ditëve** nga data e intervistës, për të plotësuar informatat e dhëna gjatë intervistës.

(5) Zgjerimi ose zgjatja e Procedurës së Hetimit

Neni 14 (4) i Rregullores parasheh që Paneli Hetimor të njoftojë Këshillin dhe të kërkojë miratimin për zgjerim të hetimit disiplinor, nëse konstaton se gjyqtari ka kryer shkelje të tjera disiplinore. Neni 12(8) i Ligjit parasheh që Këshilli mund të zgjasë hetimet për një periudhë shtesë prej dy (2) muajsh në rrethana të jashtëzakonshme. Ligji megjithatë nuk përcakton rrethanat e jashtëzakonshme. Zgjerimi i hetimit mund të jetë rrethanë përjashtuese, sidomos nëse nuk ka kohë të mjaftueshme për të përfunduar hetimin brenda periudhës tre (3) mujore. Paneli Hetimor duhet të orientohet nga veprimet dhe praktikat e mira si vijon.

- Për të zgjeruar hetimin, Paneli Hetimor duhet të paraqesë menjëherë kërkesën në Këshill kur konstaton se ka bazë të arsyeshme faktike për të zgjeruar pistat e hetimit. ***FS10 Kërkesa e Panelit Hetues tek Këshilli për zgjerim të hetimit, Shtojca 1.*** Nëse zgjerimi i hetimit kërkon kohë përtej afatit tre (3) mujor, Paneli Hetimor duhet të përfshijë edhe kërkesën për të zgjatur periudhën e hetimit (shih edhe pikat më poshtë).
- Nëse Këshilli miraton kërkesën, Paneli Hetimor duhet të informojë subjektin e hetimit për pretendimet e reja, në përputhje me hapat për njoftimin me shkrim për fillimin e procedurës hetimore, të përshkruar më sipër. ***Shih FS11, Njoftimi për subjektin e hetimit për zgjerim të hetimeve, Shtojca 1.***
- Shënim: Një arsye e mundshme për zgjerimin e fushëveprimit të hetimit është bashkimi i ankesave të tjera disiplinore në trajtim e sipër ndaj subjektit të hetimit, ashtu që të shmanget rasti ku dy panele të veçanta hetojnë paralelisht një subjekt hetues. Nëse Këshilli *sua sponte* (me vetë-iniciativë) do të bashkonte ankesat disiplinore tek një Panel Hetimor, atëherë Këshilli efektivisht do të zgjeronte fushëveprimin e hetimit, si dhe duhet që po ashtu të marrë në konsideratë edhe zgjatjen e periudhës së hetimit.
- Për zgjatje të periudhës së hetimit, Paneli Hetimor duhet të paraqesë kërkesë në Këshill, kur konstaton se nuk ka kohë të mjaftueshme për të përfunduar hetimin. Ky konstatim duhet të bëhet jo më vonë se fundi i muajit të dytë të hetimit, ashtu që të ketë kohë të mjaftueshme që Paneli Hetimor të veprojë nëse Këshilli e refuzon kërkesën. Paneli Hetimor duhet të japë arsyetimin e rrethanave të jashtëzakonshme për zgjatjen e hetimit. ***Shih FS12 Kërkesa e Panelit Hetues tek Këshilli për zgjerim të hetimit, Shtojca 1.***

- Nëse Këshilli miraton kërkesën, Paneli Hetimor duhet të informojë subjektin e hetimit se periudha e hetimit është zgjatur. *Shih FS13, Njoftimi për subjektin e hetimit për zgjerim të hetimeve, Shtojca 1.*

(6) Përmbajtja dhe paraqitja e raportit të Panelit Hetimor

Neni 12(8) i Ligjit parasheh që Paneli i Hetimit, pas përfundimit të hetimit, i dorëzon raport me shkrim Këshillit, duke paraqitur faktet dhe provat e mbledhura. Paneli gjithashtu obligohet të paraqesë raportin tek subjekti i hetimit dhe Autoriteti Kompetent. Neni 14(5) i Rregullores kërkon që Paneli të paraqesë raportin me shkrim brenda pesëmbdhjetë (15) ditëve nga përfundimi i hetimit të Panelit. Rregullorja parasheh që raporti duhet të specifikojë gjetjet dhe provat e mbledhura gjatë procedurës hetimore. Ligji dhe Rregullorja nuk specifikon elementet e as përmbajtjen e raportit hetimor të Panelit. Rekomandohet që raporti i Panelit të Hetimor për Këshillin të orientohet sipas strukturës së raportit dhe përmbajtjes së përshkruar më poshtë. Në shtojcën e këtij udhëzuesi referues është dhënë modeli për raportin e hetimit, me shënime se si të plotësohet secila pjesë. *Shih FS3, Raporti i Planit të Hetimit, në Shtojcën 1.*

Duhet të theksohet se Ligji dhe Rregullorja nuk përcaktojnë qartë se Paneli i Hetimor, në raportin e tij të hetimit, duhet të propozojë sanksionin nëse konstaton se është kryer shkelja disiplinore. Sidoqoftë, neni 13 i Ligjit parasheh që Paneli Hetimor mund të lidhë marrëveshje vullnetare me subjektin e hetimit, e cila përmban gjendjen faktike të shkeljeve disiplinore të dakorduara nga subjekti i hetimit, si dhe sanksionin disiplinor të dakorduar. Neni 13 (3) i Ligjit parasheh që marrëveshja vullnetare ka të njëjtin efekt juridik si vendimi i Këshillit për shkeljen disiplinore. Neni 14 (8) i Rregullores parasheh që marrëveshja vullnetare duhet t'i paraqitet Këshillit për shqyrtim dhe miratim. Meqenëse Ligji autorizon Panelin të vendosë, ose të paktën të propozojë, sanksionin disiplinor në rastin e marrëveshjes vullnetare, është e arsyeshme që Paneli të propozojë sanksionin në raportin e tij të hetimit të paraqitur në Këshill, nëse konstaton se subjekti i hetimit ka kryer shkelje disiplinore.

(1) Përmbajtja e Raportit të Hetimit

Përmbajtja e raportit të hetimit, e përshkruar më poshtë, përputhet me pjesët dhe përmbajtjen informuese që është dhënë në formularin e Raportit të Panelit të Hetimit. *Shih FS14A dhe FS14B, Raporti i Planit të Hetimit, në Shtojcën 1.* Modeli i raportit të hetimit përmban gjashtë (6) pjesë, si dhe është strukturuar për të ndihmuar Panelin Hetimor në hartimin e një raporti të hollësishëm të hetimit, me gjetjet dhe konkludimet e mbështetura me prova si dhe të shpjeguara në mënyrë të arsyetuar, që arsyeton edhe vendimin e Panelit. *FS14B* lë pa përfshirë Pjesën 5 që ka të bëjë me sanksionet disiplinore për arsyet e diskutuara më poshtë tek *Pjesa 5 - Sanksioni i Propozuar Disiplinor*.

Pjesa 1, Përmbledhje e Procedurave Para-Hetimore. Qëllimi i kësaj pjese është të përmbledhë informatat në prapavijë lidhur me shkeljet e supozuara disiplinore, të siguruar para hetimit nga Paneli Hetimor. Pjesa 1, përfshin edhe tri (3) nën-pjesë që japin informata që i paraprijnë krijimit të panelit. Të tri (3) nën-pjesët kërkojnë informatat si vijon:

- (1) përmbledhja e pretendimeve të ankuesit;
- (2) përmbledhja e konstatimeve nga organi kompetent;
- (3) përmbledhja e vendimit të Këshillit për krijimin e Panelit Hetimor.

Pjesa 2, Përmbledhje e Procedurave Hetimore. Qëllimi i kësaj pjese është të përmbledhë procedurat e Panelit Hetimor gjatë fazës së hetimit të kryer nga Paneli. Qëllimi është që të renditen procedurat ose veprimet e Panelit, preferohet në mënyrë kronologjike, për të ofruar

një pasqyrë të veprimeve të Panelit në mbledhjen e provave. Përmbledhja e provave të mbledhura nga Paneli paraqitet në Pjesën 3; prandaj, kjo pjesë duhet të përqendrohet në përshkrimin e procedurave dhe veprimeve të Panelit apo subjektit të hetimit, e jo të përshkruajë detajisht provat që mblidhen. Pjesa 2, duhet të përshkruajë veprimet e ndërmarra nga Paneli i Hetimit në grumbullim të provave - për shembull, njoftimi për subjektin e hetimit, kërkesat për dokumente, dëshmitarët e intervistuar, kërkesat për Këshillin, si dhe veprime të tjera nga Paneli në lidhje me hetimin. Kjo pjesë po ashtu, duhet të shtjellojë kërkesat apo veprimet formale nga subjekti i hetimit, të tilla si përgjigja fillestare e subjektit të hetimit, kërkesa për këqyrje të shkresave/provave të Panelit, ose çështje të ngjashme.

Pjesa 3, Përmbledhje e Provave të Mbledhura nga Paneli. Qëllimi i kësaj pjese është të shtjellojë provat e mbledhura gjatë hetimit të Panelit. Pjesa 3, përmban pesë (5) nën-pjesë:

- (1) Përmbledhje e Provave të Mbledhura nga Paneli;
 - Kategorizimi dhe përmbledhja e provave sipas lidhjes së tyre me secilin pretendim të shkeljes disiplinore;
- (2) Përmbledhje e Deklaratave të Dëshmitarëve të Marra nga Paneli;
 - Kategorizimi dhe përmbledhja e dëshmimeve nga dëshmitarët sipas lidhjes së tyre me secilin pretendim të shkeljes disiplinore;
 - Përshkrimi i dëshmimeve të dëshmitarëve që vënë në dyshim provat/deklaratat tjera dhe/ose dëshmitë e dëshmitarëve;
 - Përshkrimi i dëshmimeve të dëshmitarëve që shkon në favor të provave/deklaratave tjera dhe/ose dëshmitë e dëshmitarëve.
- (3) Përmbledhje e Deklaratës së subjektit të hetimit para Panelit;
 - Kategorizimi dhe përmbledhja e provave (të argumentuara) dhe dëshmimeve të dorëzuara nga subjekti i hetimit, sipas lidhjes së tyre me secilin pretendim të shkeljes disiplinore;
 - Përshkrimi i provave që vënë në dyshim provat/deklaratat tjera dhe/ose dëshmitë e dëshmitarëve;
 - Përshkrimi i dëshmimeve të dëshmitarëve që shkon në favor të provave/deklaratave tjera dhe/ose dëshmitë e dëshmitarëve.
- (4) Përmbledhje e Provave të subjektit të hetimit të paraqitura tek Paneli;
 - Kategorizimi dhe përmbledhja e provave sipas lidhjes së tyre me secilin pretendim të shkeljes disiplinore;
- (5) Përmbledhje e provave të tjera të siguruar nga Paneli (nëse ka);
 - Kategorizimi dhe përmbledhja e provave dhe dëshmimeve që nuk janë përmendur më lartë, sipas lidhjes së tyre me secilin pretendim të shkeljes disiplinore.

Pjesa 4, Gjendja faktike dhe Konkluzionet. Qëllimi i kësaj pjese është deklarimi i fakteve relevante dhe konkluzioneve të Panelit Hetimor. Pjesa 4, duhet të paraqesë gjendjen faktike të vërtetuar nga Paneli. Gjendja faktike e vërtetuar është themeli i ndërtimit të analizës së arsyetuar të fakteve, si bazë për konstatimet e Panelit lidhur me secilën shkelje të supozuar disiplinore. Zbatimi i një standardi të provës mund ta ndihmojë Panelin në peshimin e provave, paraqitjen e analizës së arsyetuar të fakteve, si dhe konstatimin nëse pretendimet janë të bazuara ose jo - domethënë, nëse shqyrtimi i arsyetuar i gjendjes faktike, aplikimi i të drejtës materiale, çojnë tek konstatimi nëse shkelja disiplinore është kryer apo jo.

- (1) Faktet e pakontestueshme;
 - Përmbledhja e fakteve të pakontestueshme/jo kundërthënëse në rastin disiplinor.

(2) Faktet e kontestueshme;

- Përmbledhja e fakteve të kontestueshme/kundërthënëse;
- në rastet kur kontestohen fakte të rëndësishme, këto duhen identifikuar e shpjeguar se pse provat bazohen mbi to, si dhe pse i falet besimi më shumë njëres, apo preferenca njëres kundrejt tjetres;

(3) Arsyetimi

Standardi i provës. Standardi i provës që pranohet në kuptimin e vendosjes nëse faktet vërtetojnë apo hedhin poshtë pretendimin në raste disiplinore është “prova të qarta dhe bindëse”. Zbatimi i standardit të provës ka rëndësi në analizimin e fakteve, zbatimin e të drejtës materiale mbi ato fakte, si dhe arritjen tek konstatimi nëse gjendja faktike mbështet apo jo në gjetjen se është kryer shkelja disiplinore. Definicioni për “prova të qarta dhe bindëse” kërkon gjendja faktike e vërtetuar të ketë gjasa shumë më të larta e substancialisht më të shumta që të jetë e vërtetë, sesa që të mos jetë e vërtetë, që subjekti i hetimit ka kryer shkelje disiplinore. Praktika gjyqësore në Shtetet e Bashkuara ka definuar “provat e qarta dhe bindëse” si prova që “krijojnë ... besim apo bindje të fuqishme në lidhje me vërtetësinë e pretendimeve që duhen vërtetuar, prova aq të qarta, të drejtpërdrejta e me peshë sa të shpjen [vështruesin] të arrijë në një bindje të qartë, pa ngurrim, për faktet precize në fjalë”. Në rastin Carlia M. Brady, 243 N.J. 395 (2020)]

- Këtu shkruhet definicioni i standardit të provës që zbatohet nga Paneli i Hetimit.
- Të shqyrtohet përdorimi i përkufizimit "prova të qarta dhe bindëse"
- Shënim: Në Shtetet e Bashkuara, standardi i provës së qartë dhe bindëse zbatohet në disa juridiksione, si Kalifornia. Në juridiksione të tjera, si Nju Jorku, zbatohet vetëm standardi "epërsia e provave", që është standard më i ulët i provës. Preferohet që standardi i provës të parashihet me Ligj ose Rregullore.

Gjendja faktike dhe Konkluzionet. Qëndrueshmëria e gjendjes faktike dhe konstatimeve nga ana e Panelit Hetimor varet nga analiza metodologjike, e arsyetuar e provave të mbledhura. Analiza e arsyetuar e provave lidhur me secilin pretendim për shkelje disiplinore përfundon me vendimin e Panelit që faktet vërtetojnë shkeljen disiplinore, faktet hedhin shkeljen disiplinore, ose faktet janë të pamjaftueshme për të vërtetuar (ose hedhur poshtë) shkeljen disiplinore, duke zbatuar standardin e provës. Për secilin pretendim, diskutohen elementet vijuese:

- Theksohet nëse ka fakte të pakontestueshme; nëse jo, identifikohen faktet që kontestohen;
- Për çdo kontestim fakti, theksohen dëshmitë apo provat tjera të përdorura për vërtetimin e fakteve, sidomos nëse dëshmisë së një dëshmitari i falet më shumë besim se tjetrit;
- Nëse kontestohet e drejta materiale e zbatuar, përmendet arsyeja pse vlen një interpretim ligjor kundrejt një tjetri;
- Nëse pretendimi është i qëndrueshëm, theksohet nëse veprimi i subjektit hetues është bërë me dashje apo jo;
- Nëse pretendimi nuk është i qëndrueshëm, theksohen arsyet, d.m.th faktet nuk vërtetohen me prova të mjaftueshme, faktet e vërtetuara nuk përbëjnë shkelje disiplinore, mbrojtja afirmative e vërtetuar nga subjekti i hetimit.

Pjesa 5, Sanksioni i propozuar disiplinor. Qëllimi i kësaj pjese është të shqyrtojë faktet dhe rrethanat e marra parasysh nga Paneli i Hetimor në rekomandimin e sanksionit disiplinor për shqyrtim nga Këshilli. Ligji dhe Rregullorja nuk e ndalojnë Panelin nga propozimi i sanksionit

disiplinor. Megjithatë, neni 13 i Ligjit parasheh që në rastin e marrëveshjes vullnetare, Paneli dhe subjekti i hetimit mund të pranojnë gjendjen faktike dhe konstatimet ligjore, duke pranuar shkeljen(t) disiplinore (marrëveshje me pëlqim të ndërsjellë). Marrëveshja vullnetare duhet të përfshijë sanksionin e dakorduar disiplinor. Kështu, sipas nenit 13, Paneli duhet të propozojë sanksionin disiplinor sipas Pjesës 5 në Raportin e vet të Hetimit. Këshilli, si organ përfundimtar gjykues, vendos si i pavarur sanksionin disiplinor¹.

Tek Pjesa 5, Paneli Hetimor shqyrton faktorët për sanksione disiplinore (rrethana rënduese ose lehtësuese) si bazë për rekomandimin e sanksionit disiplinor. Neni 7 i Ligjit numëron pesë(5) lloje të sanksioneve dhe parasheh që sanksionet disiplinore duhet të jenë në përputhje me parimin e proporcionalitetit, si dhe të marrin parasysh faktorët e mëposhtëm:

- (1) numri dhe serioziteti i shkeljeve disiplinore të kryera nga subjekti i hetimit;
- (2) pasojat e shkelës disiplinore;
- (3) rrethanat në të cilat janë kryer shkeljet disiplinore;
- (4) performanca e përgjithshme dhe sjellja e subjekti i hetimit;
- (5) sjellja dhe niveli i bashkëpunimit të subjektit të hetimit gjatë procedurës disiplinore.

Pjesa 5, duhet të përmbajë analizën e arsyetuar të Panelit për rrethanat e sanksioneve disiplinore, si bazë për propozimin e sanksionit disiplinor. Paneli duhet të marrë parasysh faktorët e dhënë në nenin 7(2). Për më tepër, si praktikë e mirë, Paneli mund të marrë parasysh faktorë të tjerë të renditur më poshtë, si relevantë, për të siguruar konsistencë dhe proporcionalitet në vendosjen e sanksioneve.

(1) Rrethanat e Sanksioneve Disiplinore (Rënduese dhe lehtësuese)

- të identifikohen rrethanat e sanksioneve që lidhen me secilën gjetje e konstatim të Panelit që është kryer shkelja disiplinore;
- të merren parasysh rrethanat e sanksioneve disiplinore të renditura tek neni 7(2) i Ligjit;
- të konsiderohen edhe rrethana të tjera relevante që japin indikacione për rrethana rënduese apo lehtësuese:

rrethana të tjera relevante/rënduese (praktika të mira)

- përvoja në shërbim në pozitë gjyqësore (sjellja nuk mund t'i atribuohet mungesës së përvojës apo trajnimit);
- subjekti i hetimit nuk ka marrë në njohuri kryerjen e shkelejes disiplinore apo peshën e atij veprimi/sjelljeje;
- subjekti i hetimit nuk ka pranuar përgjegjësinë për veprimet;
- ankesa të tjera paraprake/paralele të natyrës së ngjashme lidhur me subjektin e hetimit;
- shkelja përfshin keqpërdorimin e pozitës ndaj personelit vartës;
- shkelje që dëshmohet nga një vazhdimësi apo praktikë e vazhdueshme (e përsëritur);

¹ Për të siguruar konsistencë në aplikimin e sanksioneve disiplinore, Këshilli duhet që përfundimisht të vendosë sanksionin disiplinor. Kështu, Këshilli duhet të ketë lirinë të refuzojë sanksionin e propozuar nga Paneli në raportin e vet hetimor, apo sipas ujdisë vullnetare. Nuk është në pajtim me praktikën e mira ndërkombëtare që Paneli dhe i padituri të vendosin sanksionin, pasi që Këshilli është organi i duhur gjykues për të vendosur përfundimisht nëse faktet e mbështesin konstatimin që është kryer shkelja disiplinore, si dhe cili është sanksioni i duhur për të. Neni 13(3) i Ligjit parasheh që ujdia vullnetare e miratuar nga Paneli duhet të ketë efektin juridik ashtu si vendimi i Këshillit për shkeljen disiplinore. Kjo dispozitë është problematike në kuptimin që shihet si uzurpim i funksionit të Këshillit për vendosjen e pavaur nëse i padituri ka kryer shkelje disiplinore, si dhe nëse po, për vlerësimin e pavarur të fakteve dhe rrethanave në përcaktimin e sanksionit të arsyeshëm

- sjellja ka ngjarë në cilësinë zyrtare të subjektit të hetimit (që ndikon në rolin gjyqësor);
- shkelja përfshin mungesë integriteti apo pandershmëri;
- shkelja me dashje, me paramendim, me pakujdesi apo spontane ka dëmtuar palë të tjera;
- shkelja rezulton me dëme ndaj personave të pafajshëm apo viktimave të tjera, si dhe niveli i dëmit;
- sjellja ka pasur motiv personal, interes në drejtësi, apo interes për hakmarrje;
- shkelja ka dëmtuar integritetin e sistemit të drejtësisë dhe respektin për të;
- sjellja e tillë përfshin zbatim të pabarabartë të drejtësisë në baza racore, etnike apo të prejardhjes kombëtare, të gjinisë, orientimit seksual, apo fesë.

Rrethana të tjera relevante/lehtësuese (Praktikë e mirë)

- kohëzgjatja e shërbimit në pozitë gjyqësore (sjellja i atribuohet mungesës së përvojës, trajnimit);
 - kohëzgjatja e shërbimit në pozitë gjyqësore (shumë vite në shërbim të drejtësisë pa shkelje);
 - subjekti i hetimit e ka pranuar shkeljen, si dhe ka demonstruar përpjekje për të ndryshuar sjelljen e tillë;
 - subjekti i hetimit i ka pranuar përgjegjësitë lidhur me veprimet;
 - sjellja e kryer në jetën private të subjektit të hetimit (dhe që nuk ndikon në rolin e gjyqësorit).
- Me anë të rrethanave si më lartë, kategorizohen dhe përmbledhen të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese që janë relevante për rastin disiplinor;
 - për secilën rrethanë lehtësuese ose rënduese, paraqiten faktet dhe provat që vërtetojnë rrethanën rënduese si dhe ofrohet baza e arsyetuar për atë rrethanë, si dhe pse është rënduese. Për secilën rrethanë lehtësuese ose rënduese, paraqiten faktet dhe provat që arsyetojnë rrethanën lehtësuese dhe rënduese.

(2) Rekomandimi i Sanksionit Disiplinor:

- Theksohet sanksioni(et) disiplinore të propozuara dhe përmbledhet baza për propozimin e sanksioneve, si arsyetim për propozimin e Panelit për sanksionin disiplinor;
- nëse Paneli rekomandon më shumë se një sanksion, jepet arsyetimi për secilin sanksion.

Pjesa 6, Lista e Shtojcave. Qëllimi i kësaj pjese është të specifikohen informatat relevante apo plotësuese që mbështesin gjetjet dhe konkluzionet e Panelit. Paneli duhet të specifikojë dokumentet përkatëse në renditje kronologjike ose sipas temës/çështjes, apo ndonjë kategorizimi tjetër.

(2) Dorëzimi i Raportit të Hetimit

Dorëzimi i Raportit të Panelit të Hetimor në Këshill . Neni 14 i Rregullores parasheh që Paneli Hetimor duhet të paraqesë raport me shkrim me gjendjen faktike dhe provat tek Këshilli, subjekti i hetimit dhe Autoriteti Kompetent që ka kërkuar hetimin. Paneli paraqet raportin me shkrim brenda pesemebdhjetë (15) diteve nga përfundimi i hetimit. Shkresa përcjellëse e raportit me shkrim nga Paneli Hetimor tek Këshilli, subjekti i hetimit, si dhe Autoriteti Kompetent, duhet të ofrojë këshillën juridike për të drejtën e qasjes në shkresa të rastit si dhe

në prova që janë mbledhur nga Paneli Hetimor. *Shih FS 14-16, Shkresat përcjellëse të Panelit Hetimor (Autoriteti Kompetent, subjekti i hetimit dhe Këshilli) në Shtojcën 1.* Shtojca 1 përmban shkresat e posaçme përcjellëse për Këshillin, subjektin e hetimit dhe Autoritetin Kompetent.

E. Formularët përkatës

FS 1-16 në Shtojcën 1 janë për dobi të Panelit Hetimor gjatë fazës së procedurës hetimore.

PJESA 6: TË DREJTAT E SUBJEKTIT TË HETIMIT NË PROCES TË RREGULLT

A. Referencat ligjore

Ligji dhe Rregullorja përmbajnë dispozita që mbrojnë të drejtat e subjektit të hetimit gjatë gjitha fazave të procesit disiplinor. Ligji dhe Rregullorja, të lexuar së bashku, vendosin detyrime të rëndësishme për Autoritetin Kompetent, Panelin Hetimor dhe Këshillin, për të siguruar që subjekti i hetimit të jetë i informuar, të ketë proces të rregullt dhe të trajtohet drejt gjatë të gjitha fazave të procedurës disiplinore. Neni 12(11) i Ligjit parasheh që KPP zbatohet *mutatis mutandis* në grumbullimin e provave dhe të drejtat e personave nën-hetim. Neni 14 i Rregullores, i cili specifikon veprimet procedurale të Panelit Hetimor, parasheh që panelet hetimore të kryejnë hetime në përputhje me nenin 12(6)-(11).

Ligji dhe Rregullorja përmbajnë dispozita që theksojnë të drejtat e subjektit të hetimit dhe kërkesën për të siguruar drejtësi dhe proces të rregullt në procedurë disiplinore. Neni 12 i Ligjit përcakton se dispozitat e KPP-së zbatohen *mutatis mutandis* në procedurën për të drejtat e personave nën hetim dhe mbledhjen e provave. Ndërsa procesi disiplinor nuk është *në vetvete* procedurë penale, është e rëndësishme që Autoriteti Kompetent, Paneli Hetimor dhe Këshilli të njohin mirë dhe të integrojnë masat mbrojtëse kryesore procedurale nga KPP-ja në procedurën dhe praktikën e tyre, ashtu që procedura disiplinore të jetë në përputhje me standardet e pranura të procesit të rregullt. Neni 14 i Rregullores numëron të drejtat e subjektit të hetimit, të cilat duhet të respektohen në të gjitha fazat e procedurës disiplinore, veçanërisht në fazën e hetimit. Duhet të theksohet se Ligji dhe Rregullorja kanë shtrirje të gjerë, si dhe përmbajnë boshllëqe në procedurën disiplinore, duke sjellë edhe mungesë të udhëzimeve për Panelin Hetimor se si të mbledhë prova në mënyrë që të respektojë të drejtat e subjektit të hetimit. Sidoqoftë, asgjë në Ligj ose Rregullore nuk e pengon zbatimin e praktikave të mira për të mbushur boshllëqet, e në këtë mënyrë të sigurohet një proces i rregullt.

B. Procedura

1. Faza para-hetimore

Gjatë fazës para-hetimore, Ligji dhe Rregullorja janë të heshtura lidhur me njoftimin e subjektit të hetimit për ankesën kundër tij/saj, apo marrjen e deklaratës nga subjekti i hetimit. Në këtë kuptim, Ligji dhe Rregullorja ofrojnë udhëzime të mjaftueshme për njoftimet, për të mbrojtur të drejtat e subjekti i hetimit për proces të rregullt.

Neni 12(6) i Ligjit parasheh që nëse Autoriteti Kompetent konstaton se ankesa është joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me shkelje disiplinore, ose është parashkruar, ai duhet të njoftojë ankuesin dhe Këshillin për vendimin e tij. Në këtë fazë, nuk ka detyrim të njoftohet subjekti i hetimit.

Neni 6(4) i Rregullores parasheh që Autoriteti Kompetent mund të kërkojë deklaratë nga subjekti i hetimit. Neni 7 i Rregullores jep një referencë për "seancën fillestare" dhe parasheh që me fillimin e veprimeve fillestare, Autoriteti Kompetent mund ta hedhë poshtë, refuzojë ose të kërkojë nga Këshilli të fillojë hetimin. Autoriteti Kompetent duhet të njoftojë ankuesin, subjektin e hetimit dhe Këshillin për vendimin e tij. Në rastet kur subjekti i hetimit nuk është njoftuar më parë për ankesën dhe ankesa hedhet poshtë menjëherë nga Autoriteti Kompetent si joserioze, nuk ka nevojë të njoftohet subjekti i hetimit për mbylljen e rastit.

2. Faza hetimore:

Gjatë fazës hetimore, Ligji dhe Rregullorja përcaktojnë procedura specifike që mbrojnë të drejtat e subjekti i hetimit.

- Neni 12 (7) i Ligjit përcakton se Paneli Hetimor duhet t'i sigurojë subjektit të hetimit (1) mundësinë për t'u dëgjuar, (2) për t'iu përgjigjur pretendimeve, (3) për t'u përfaqësuar nga avokati mbrojtës, si dhe (4) të ketë qasje në të gjithë provat e mbledhura nga paneli hetimor.
- Neni 14(1) i Rregullores kërkon që Paneli Hetimor të njoftojë me shkrim subjektin e hetimit se ndaj tij është iniciuar hetimi. Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë informata mbi shkeljen e supozuar disiplinore dhe përbërjen e Panelit Hetimor. Njoftimi gjithashtu duhet të japë këshilla juridike për të drejtat e subjektit të hetimit: (1) të dëgjohet lidhur me ankesën, (2) të ketë qasje të plotë në shkresat e rastit disiplinore, (3) të informohet për zgjatjen e hetimeve, (4) të paraqesë prova, dokumente dhe dëshmitarë dhe (5) të përfaqësohet nga avokati mbrojtës.

Për më tepër, neni 12(11) i Ligjit dhe neni 14(3) kërkojnë zbatimin *mutatis mutandis* të KPP-së. KPP-ja përmban disa dispozita që mbrojnë të drejtat e një të pandehuri. Dispozitat kryesore të KPP-së që mbrojnë të drejtat e një të pandehuri (domethënë subjekti të hetimit) e që vlen të përmenden:

- Neni 3: prezumimi i pafajësisë;
- Neni 4: mbrojtje nga gjykimi për të njëjtën vepër për herë të dytë nëse është liruar (*ne bis in idem*);
- Neni 5: Gjykimi i drejtë i paanshëm dhe në afat të arsyeshëm;
- Neni 9: Barazia e palëve;
- Neni 10: njoftimi i akuzave dhe ndalimi i rrëfimit të detyruar;
- Neni 16: detyrimi për të informuar palët;
- Neni 53: e drejta në avokat mbrojtës;
- Neni 152: e drejta për t'u konsultuar me avokatin mbrojtës para dhe gjatë seancës paraprake;
- Neni 174: i pandehuri këshillohet në ftesë për të drejtën në avokat mbrojtës;
- Neni 213: e drejta e qasjes në shkresa të rastit, qasje në provat e mbledhura.

C. Komente

Për të pasur hetim të drejtë, Paneli Hetimor duhet të informojë plotësisht subjektin e hetimit për të drejtat e tij/saj. Së pari, Paneli Hetimor duhet të ofrojë njoftime të mirëfillta dhe në kohë për subjektin e hetimit, mbi pretendimet dhe të drejtën për avokat mbrojtës. Subjekti i hetimit ka të drejtë të dijë natyrën e pretendimeve dhe shtrirjen e hetimeve. Këto informata i mundësojnë subjektit të hetimit, me ndihmën e avokatit mbrojtës, nëse angazhon një të tillë, të përgatisë mbrojtjen dhe të mbledhë dokumente dhe dëshmitarë në përgjigje ndaj shkeljeve disiplinore të pretenduara. Gjithashtu, njoftimi me kohë për përmbajtjen e pretendimeve dhe shtrirjen e hetimeve i mundësojnë subjektit të hetimit të mbrohet më mirë, si dhe të ofrojë informatat relevante, të cilat e ndihmojnë hetimin edhe nga ana e Panelit Hetimor.

Së dyti, për t'i siguruar subjektit të hetimit mundësinë efektive për t'u dëgjuar, Paneli Hetimor duhet të ftojë subjektin e hetimit të japë përgjigje fillestare ndaj pretendimeve, të propozojë dëshmitarë për intervistim nga Paneli, si dhe të ofrojë prova për Panelin. Afër përfundimit të hetimit, pasi Paneli të ketë mbledhur dëshmi e prova, Paneli Hetimor duhet ta ftojë subjektin e

hetimit të paraqesë përgjigjen formale para Panelit, si dhe të paraqesë prova në mbështetje të qëndrimit të subjektit të hetimit. Paneli duhet ta njoftojë subjektin e hetimit, se mund ta marrë në pyetje lidhur me çështjet faktike që janë relevante për rastin disiplinor.

Së treti, Paneli duhet të këshillojë subjektin e hetimit për të drejtën e qasjes në dosjen e hetimeve të Panelit, si dhe provat e mbledhura sipas Ligjit, nenit 14(7) dhe Rregullores, nenit 14(1). Ligji dhe Rregullorja nuk parashohin se kur subjekti i hetimit mund të ketë qasje në shkresa dhe prova. Paneli duhet të ofrojë kohë të mjaftueshme që subjekti i hetimit të shikoj shkresat e rastit të Panelit, afër përfundimit të hetimit, kur caktohet intervista me subjektin e hetimit. Gjatë intervistës, subjekti i hetimit mund të përgjigjet ndaj të gjitha pretendimeve dhe të paraqesë prova në të kundërtën e tyre, si dhe t'i mundësojë Panelit të marrë në pyetje subjektin e hetimit për çështje faktike, si dhe për çështjet ku Paneli ka nevojë për sqarime.

Kjo nën-pjesë përmban praktikatat e mira lidhur me të drejtat e subjektit të hetimit. Praktikatat e mira dhe informatat e dhëna mund të jenë të dobishme për të orientuar Panelin Hetimor se si dhe kur duhet të angazhojë vetë subjektin e hetimit gjatë procedurës hetimore. Praktikatat e mira që rekomandohen në këtë pjesë janë këshilluese dhe nuk kanë për qëllim të zënë vendin e Ligjit apo Rregullores.

D. Rekomandimet si praktika të mira

Kjo nën-pjesë ofron informata që mund të përdoren për të njoftuar subjektin e hetimit me të drejtat e tij/saj gjatë procedurës disiplinore. Ofrimi i informatave për subjektin e hetimit që në fillim të procesit disiplinor rekomandohet për t'u siguruar që subjekti i hetimit të kuptojë plotësisht të drejtat e tij/saj për proces të rregullt ligjor. Të drejtat e renditura më poshtë u përgjigjen të drejtave të subjektit të hetimit të përcaktuara në nenin 12(7) i Ligjit; Neni 14(1) i Rregullores; si dhe dispozitat kyçe të KPP-së (shih më lart).

- **E DREJTA PËR AVOKAT MBROJTËS.** Ju keni të drejtë të përfaqësoheni nga avokati. Në rast se përfaqësoheni nga avokati, ju ose përfaqësuesi juaj duhet të njoftoni menjëherë Panelin për përfaqësim me prokurë. Përfaqësuesi me prokurë mund të komunikojë me Panelin në emër të palës. Përfaqësuesi me prokurë mund të jetë i pranishëm me subjektin e hetimit në çdo takim me Panelin e Hetimit dhe të përfaqësojë subjektin e hetimit gjatë gjithë procesit.
- **E DREJTA PËR T'U DËGJUAR.** Subjekti i hetimit ka të drejtë të dëgjohet, duke përfshirë dhënien e përgjigjeve ndaj pretendimeve, personalisht ose me shkrim, paraqitjen e provave dhe propozimin e dëshmitarëve. Kjo është mundësi për Panelin që të kuptojë pozitën e subjektit të hetimit, si dhe që Paneli të arrijë të identifikojë faktet relevante për vërtetimin e gjendjes faktike.
- **E DREJTA E QASJES SË PLOTË NË DOSJEN DISIPLINORE.** Subjekti i hetimit mund të kërkojë qasje në shkresat e rastit disiplinor dhe provat e mbledhura nga Paneli.
- **E DREJTA PËR T'I INFORMUAR PËR ZGJATJEN APO ZGJERIMIN E FUSHËVEPRIMIT TË HETIMIT.** Nëse, me kërkesë të Panelit, Këshilli zgjatë periudhën e hetimit ose zgjeron fushëveprimin e hetimeve, Paneli njofton ë subjektin e hetimit brenda dhjetë (10) ditëve nga data e vendimit të Këshillit.

- E DREJTA E PARAQITJES SË DËSHMIVE / PROVAVE OSE E PROPOZIMIT TË DËSHMITARËVE. Gjatë fazës së hetimit, subjekti i hetimit mund t'i paraqesë Panelit dëshmi e prova relevante ose të propozojë dëshmitarë që mund të kontaktohen nga Paneli, si dhe sipas nevojave të Panelit, të deklarohet.

E. Formularët përkatës

Formulimet këshilluese si më sipër lidhur me të drejtat e subjektit të hetimit janë shtjelluar tek Formularët Standardë në Shtojcën 1, konkretisht:

- *FS 1, Njoftimi për Procedurën e Hetimit (subjekti i hetimit)*
- *FS11, Njoftimi për subjektin e hetimit për zgjerim të hetimeve*
- *FS13, Njoftimi për subjektin e hetimit për zgjatje të hetimeve*

PJESA 7: MARRËVESHJA VULLNETARE NË RASTET DISIPLINORE

A. Referencat ligjore

Neni 13 i Ligjit dhe neni 14(7) i Rregullores parashohin marrëveshjen vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore, që lidhet ndërmjet Panelit të Hetimor dhe subjektit të hetimit. Neni 14(8) i Rregullores parasheh që marrëveshja vullnetare të dorëzohet për shqyrtim dhe aprovim në Këshill.

B. Procedura

Neni 13 (1) i Ligjit parasheh që edhe Paneli Hetimor edhe subjekti i hetimit duhet të bien dakord për zgjidhjen vullnetare të shkeljeve disiplinore të pretenduara.

Neni 13(2) kërkon që marrëveshja vullnetare e zgjidhjes të përmbajë:

- (1) deklarimin faktik të shkelejes disiplinore që pranohet nga subjekti i hetimit; dhe
- (2) sanksionin disiplinor të dakorduar.

Sipas nenit 13(3) të Ligjit, marrëveshja vullnetare e aprovuar nga Paneli ka të njëjtin efekt juridik si vendimi i Këshillit për shkeljen disiplinore.

C. Komente

Neni 13 i Ligjit parasheh marrëveshjen vullnetare për rastin disiplinor, përmes një marrëveshje të pëlqimit të përbashkët ndërmjet Panelit të Hetimit dhe subjektit të hetimit. Neni 13(3) i Ligjit parasheh që marrëveshja e aprovuar nga Paneli Hetimor ka të njëjtin efekt juridik si vendimi i Këshillit për shkeljen disiplinore. Megjithëse neni 13(3) mund të hapë rrugë për interpretimin se zgjidhja vullnetare është ligjërish e detyrueshme për Këshillin, neni 14(8) precizon se marrëveshja vullnetare paraqitet për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli, duke sugjeruar që marrëveshja nuk është ligjërish e detyrueshme për Këshillin. Ligji dhe Rregullorja heshtin për sa i përket refuzimit të marrëveshjes nga Këshilli ose nëse ka autorizimin për të pranuar marrëveshjen, por të vendosë sanksion ndryshe nga sanksioni për të cilin ka dakordim nga Paneli i Hetimit dhe subjekti i hetimit. Një praktikë e pranuar ndërkombëtare është që marrëveshja e pëlqimit të përbashkët të theksojë që Këshilli mund të refuzojë marrëveshjen dhe të vazhdojë me procedurat disiplinore. Nëse Këshilli e refuzon marrëveshjen, atëherë asgjë nga marrëveshja e pëlqimit të përbashkët nuk mund të konsiderohet e pranuar nga subjekti i hetimit, si dhe çdo pranim i shkeljes nga subjekti i hetimit nuk mund të merret parasysh apo të referohet në procedurat vijuese disiplinore. Meqenëse sistemi disiplinor në Kosovë krijon panele të shumta hetimore me anëtarësi të panelit me rotacion në baza periodike, ekzistojnë rreziqe që sanksionet disiplinore të paraqitura në marrëveshjet e pëlqimit të përbashkët të mos jenë konsistente me kalimin e kohës, përveç nëse panelet e hetimit kanë udhëzime më të qarta në përcaktimin e sanksioneve disiplinore. Angazhimi i Këshillit në miratimin e marrëveshjeve të pëlqimit është e nevojshme për të siguruar konsistencë në sanksionet disiplinore, gjë që është e vështirë të arrihet nga Panelet Hetimore që janë me rotacion.

Neni 7(1) i Ligjit thotë se një ose më shumë sanksione disiplinore mund të shqiptohen nga Këshilli për një shkelje disiplinore, si më poshtë: (1) vërejtje jopublike me shkrim; (2) vërejtje publike me shkrim; (3) zvogëlim i përkohshëm i pagës deri në pesëdhjetë përqind (50%) për një periudhë deri në një (1) vit; (4) transferim i përkohshëm ose i përhershëm në një gjykatë apo prokurori tjetër të nivelit më të ulët; (5) propozim për shkarkim. Neni 7 (2) i Ligjit parasheh

që sanksionet disiplinore të shqiptohen bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe duke marrë parasysh pikat vijuese:

- (1) numri dhe serioziteti i shkeljeve disiplinore të kryera nga subjekti i hetimit;
- (2) pasojat e shkeljes disiplinore;
- (3) rrethanat në të cilat janë kryer shkeljet disiplinore;
- (4) performanca e përgjithshme dhe sjellja e subjektit të hetimit;
- (5) sjellja dhe niveli i bashkëpunimit të subjekti i hetimit gjatë procedurës disiplinore.

D. Rekomandimet si praktika të mira

Zbatimi i marrëveshjeve të pëlqimit të përbashkët është praktikë e mirë dhe rezulton me shfrytëzim efikas të resurseve të procesit disiplinor, duke siguruar ruajtjen e interesit publik për integritetin e gjyqësorit. Përmbajtja e marrëveshjes vullnetare, ose marrëveshjes së pëlqimit të përbashkët, të përshkruar si më poshtë, korrespondon me pikat dhe përmbajtjen e informatave të dhëna në formularin e Marrëveshjes së Pëlqimit të Përbashkët. *Shih FS3, Marrëveshje Vullnetare për shkelje e supozuar, në Shtojcën 1.*

Është praktikë e mirë që Paneli i Hetimor të përdorë modelin standard të Marrëveshjes së Pëlqimit të Përbashkët, ku përfshihen dy pika kryesore: (1) afatet dhe kushtet dhe (2) përcaktojnë faktet dhe konstatimet. Bashkëngjitur me Marrëveshjen *Vullnetare për shkeljen e supozuar* është edhe Dëshmia nën betim e Gjyqtarit subjekt i hetimit.

Kushtet dhe afatet

- Kushtet dhe afatet theksojnë që marrëveshja zgjidh pretendimet ndaj subjektit të hetimit, si dhe që subjekti i hetimit pranon gjendjen faktike të vërtetuar dhe zbatimin e të drejtës materiale, si dhe që pranon sanksionin disiplinor të propozuar.
- Nëse Këshilli pranon marrëveshjen e pëlqimit të përbashkët, Këshilli mund të artikulojë arsyet e vendimit të tij, si dhe të ofrojë formulime shpjeguese për atë që e gjykon të përshtatshme.
- Subjekti i hetimit heq dorë nga çdo procedim i mëtejshëm dhe shqyrtim gjyqësor të çështjes disiplinore, duke përfshirë të drejtën e ankesës në Gjykatën Supreme.
- Këshilli mund të refuzojë marrëveshjen dhe përfundimin e propozuar të rastit, si dhe të vazhdojë me procedurën disiplinore, ku në këtë rast, asgjë nga pranimet e subjektit të hetimit nuk konsiderohen më tutje si pranim nga ana e subjektit të hetimit.

Vërtetimi i gjendjes faktike dhe konstatimet ligjore

- 1. *Gjendja e vërtetuar faktike lidhur me pretendimet disiplinore.* Kjo nën-pjesë numëron pretendimet disiplinore që kanë qenë subjekt i hetimit, si dhe përshkruan faktet e dakorduara nga palët.
- 2. *Komentet e subjektit të hetimit.* Kjo nën-pjesë paraqet deklarimin e subjektit të hetimit në lidhje me sjelljen e tij/saj, siç janë shprehja e pendimit, turpiti, keqardhjes për veprimin në fjalë, si dhe premtimit të subjektit të hetimit që të mos përsërisë veprimin në të ardhmen.
- 3. *Shkeljet disiplinore.* Kjo nën-pjesë paraqet dispozitat e Nenit 5 të Ligjit që janë shkelur dhe përbëjnë shkelje disiplinore. Kjo nën-pjesë mund të përmendë edhe dispozita të tjera të rëndësishme, siç janë kodet e etikës për gjyqtarët.
- 4. *Sanksioni disiplinor.* Kjo nën-pjesë përmend rrethanat rënduese dhe lehtësuese, si bazë për propozimin e sanksionit të caktuar disiplinor.

- *5. Pretendimet që hidhen poshtë.* Kjo nën-pjesë përmend pretendimet specifike disiplinore për të cilat subjekti i hetimit nuk pranon përgjegjësinë. Arsyet për hedhje poshtë mund të jenë mungesa e provave, ose edhe nëse pretendimet do të provoheshin, niveli i sanksionit të propozuar nuk do të ndryshonte ose zgjidhja e përshpejtuar e çështjeve disiplinore tejkalon peshën e kryerjes së procedurës formale disiplinore.

Deklarata nën betim e subjektit të hetimit

- Deklarata nën betim e subjektit të hetimit i bashkëngjitet Marrëveshjes së Pëlqimit të Përbashkët. Subjekti i hetimit pranon vendosjen e sanksionit disiplinor dhe deklaron se pëlqimi është dhënë me bindje të lirë dhe vullnetarisht. Subjekti i hetimit pranon vërtetësinë e pretendimeve të dhëna në Raportin e Panelit Hetimore, si dhe heq dorë nga të gjitha procedurat e mëtejshme disiplinore, duke përfshirë të drejtën e ankesës në Gjykatën Supreme.

E. Formularët përkatës

- *FS18 Marrëveshje vullnetari për shkelje të supozuar*

SHTOJCA 1 - FORMULARËT STANDARDË

- FS1 Njoftimi për procedurën hetimore (Letër për subjektin e hetimit);
- FS2 Njoftimi për procedurën hetimore (Letër për ankuesin);
- FS3 Plani i hetimit;
- FS4 Kërkesa për dokumente nga Paneli Hetimor;
- FS5 Kërkesa për intervistim (dëshmitari) nga Paneli Hetimor;
- FS6 Lista kontrolluese për intervistë (Dëshmitari);
- FS7 Dosja e intervistës;
- FS8 Kërkesa për intervistim (subjekti i hetimit) nga Paneli Hetimor;
- FS9 Shkresa përcjellëse për intervistë (subjekti i hetimit);
- FS10 Kërkesa e Panelit Hetimor për Këshillin për zgjerimin e hetimeve;
- FS11 Njoftimi për subjektin e hetimit për zgjerim të hetimeve;
- FS12 Kërkesa e Panelit Hetimor për Këshillin për të zgjatur hetimet;
- FS13 Njoftimi për subjektin e hetimit për zgjatjen e hetimeve;
- FS14 Raporti i Panelit Hetimor (pa pjesën e sanksioneve disiplinore);
- FS14A Raporti i Panelit Hetimor (pa pjesën e sanksioneve disiplinore);
- FS15 Shkresë përcjellëse e Panelit Hetimor për Autoritetin Kompetent (Raport hetimi);
- FS16 Shkresë përcjellëse e Panelit Hetimor për subjektin e hetimit (Raport hetimi);
- FS17 Shkresë përcjellëse e Panelit Hetimor për Këshillin (Raport hetimi);
- FS18 Marrëveshje e Pëlqimit të Përbashkët.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

NË ÇËSHTJEN DISIPLINORE NDAJ [shëno emrin e gjyqtarit], SUBJEKT I HETIMIT
Dosja e Rastit Disiplinor Nr: [shëno numrin]
Data: [shëno datën dd/mm/vvvv]

NJOFTIMI PËR HAPJEN E HETIMIT DISIPLINOR (SUBJEKTI I HETIMIT)

I/e nderuar Z./Znj. [Emri i subjektit të hetimit],

Me këtë letër, ju njoftojmë që me datë dd/mm/vvvv [shënohet data e saktë kur Procedura Hetimore është miratuar nga Këshilli] Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka hapur hetimin me numër të rastit si vijon: [shëno numrin e rastit, në pajtim me nenin 12 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. **Ju lutemi, referojuni këtij numri në çdo korrespondencë të ardhshme.**

Hetimi ka të bëjë me pretendimet lidhur me veprimet tuaja si gjyqtar. Në dd/mm/vvvv, [shëno emrin e ankuesit] i ka dorëzuar Autoritetit Kompetent, [shëno emrin e Autoritetit Kompetent] ankesë me shkrim në të cilën pretendohet shkelja disiplinore. Ankesa bazohet në pretendimet vijuese: Autoriteti Kompetent ka konstatuar që ka baza të arsyeshme për të besuar se është kryer shkelja disiplinore, si dhe ka kërkuar nga Këshilli të fillojë hetimin disiplinor.

OSE

Hetimi ka të bëjë me pretendimet lidhur me veprimet tuaja si gjyqtar. Më dd/mm/vvvv, Autoriteti Kompetent, [shëno emrin e Autoritetit Kompetent], në detyrë zyrtare, ka konstatuar që ka baza të arsyeshme për të besuar se është kryer shkelja disiplinore, si dhe ka kërkuar nga Këshilli të fillojë hetimin disiplinor.

Përmbledhja e pretendimeve është dhënë më poshtë.

- Këtu paraqitet përmbledhja e pretendimeve

Dokumentet relevante apo informatat tjera të shqyrtuara në vlerësimin e pretendimeve janë:

- [lista e dokumenteve]
- [lista e informatave të tjera]

Qëllimi i Panelit Hetimor është të kryejë hetimin për të konstatuar nëse ka bazë të provave për të vendosur që është kryer shkelja disiplinore, në kundërshtim me Nenin 5 të Ligjit 06/L-057/2018 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Këshilli ka filluar procedurën hetimore me krijimin e Panelit Hetimor. Paneli përbehet nga, *[shëno emrin dhe mbiemrin dhe pozitën]*, në cilësinë e Kryetarit të Panelit Hetimor dhe anëtarëve *[shëno emrin dhe mbiemrin e anëtarëve të panelit dhe pozitën]*. Këshilli po ashtu ka caktuar anëtarët rezervë: *[shëno emrat dhe mbiemrat e anëtarëve dhe pozicioneve rezervë të panelit]*.

Për ta trajtuar këtë çështje në mënyrë të drejtë dhe efikase, inkurajoheni t'i paraqisni panelit përgjigje me shkrim në të cilën mund të pajtoheni apo të mos pajtoheni me secilin pretendim. Inkurajoheni t'i dorëzoni Panelit dokumentacionin në mbështetje të përgjigjes tuaj, si dhe të identifikoni dëshmitarët që kanë informata në lidhje me pretendimet. Këto informata mund të ndihmojnë Panelin të kuptojë më mirë pikëpamjet tuaja dhe faktet në lidhje me pretendimet. Paneli kërkon që ju të dorëzoni ato informata brenda pesëmbdhjetë (15) diteve kalendarike nga data e kësaj letrë njoftimi. Përgjigja juaj duhet të orientohet kah informatat e mëposhtme:

- Deklarohuni nëse pajtoheni apo nuk pajtoheni me secilin pretendim; nëse nuk pajtoheni me pretendimin, paraqitni faktet e kontestuara ose arsyet pse nuk pajtoheni;
- Paraqitni mbrojtjen tuaj afirmative (pohuese);
- Deklaroni versionin tuaj të fakteve që lidhen me secilin pretendim;
- Deklaroni ndonjë shpjegim që keni për shkeljen e supozuar, nëse është kryer;
- Ofroni kopje të gjitha dokumenteve të cilave iu referoheni, në përgjigjen tuaj ndaj secilit pretendim;
- Përmendni faktet që besoni se paneli duhet të ketë parasysh gjatë hetimit të kësaj çështjeje;
- Identifikoni dëshmitarët, nëse ka, që mund të mbështesin përgjigjen tuaj ose që kanë informatat relevante. *[shëno emrin dhe adresën e secilit dëshmitar, adresën elektronike dhe numrin e telefonit]*

Në përputhje me rregulloren e Këshillit për procedurën disiplinore, Paneli ju njofton për të drejtat tuaja si subjekt i hetimit në një çështje disiplinore, si më poshtë:

